



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2025/0624

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Batisha Ibrahim-Kryesuese, Kimete Gashi-Brajshori dhe Vedat Poterqoi-Anëtar të Panelit Shqyrtues duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) SEFERI-CO SH.P.K., kundër Njoftimit të kontratës ose me dokumentet e tenderit të KOMUNA SUHAREKË në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit Projekt me bashkfinancim - Ndertimi idevijiit te rruges Magjistrale ne fshatrat Duhël-Bllacë dhe rruges per tek varrezat e reja te fshatit Bllacë-Suharekë me numër të prokurimit 624-25-4485-5-1-1, me 08/09/2025, mori:

Vendim

1. Aprovohet, si pjesërisht e bazuar ankesa e SEFERI-CO SH.P.K., me nr. 2025/0624, e datës 09.07.2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit Projekt me bashkfinancim - Ndertimi idevijiit te rruges Magjistrale ne fshatrat Duhël-Bllacë dhe rruges per tek varrezat e reja te fshatit Bllacë-Suharekë me numër të prokurimit 624-25-4485-5-1-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – KOMUNA SUHAREKË.
2. Anulohet, njoftimi për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit Projekt me bashkfinancim - Ndertimi idevijiit te rruges Magjistrale ne fshatrat Duhël-Bllacë dhe rruges per tek varrezat e reja te fshatit Bllacë-Suharekë me numër të prokurimit 624-25-4485-5-1-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – KOMUNA SUHAREKË. Obligohet AK që të bëjë përmirësimet e dosjes së tenderit dhe të zgjas afatin për ofertim.
3. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP-në për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën për mos respektim të vendimit, OSHP mund të ndërmarrë masa ndaj AK sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës.
4. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 24.05.2025, KOMUNA SUHAREKË., në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar B05 Njoftimi për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull Projekt me bashkfinancim - Ndertimi idevijiit te rruges Magjistrale ne fshatrat Duhël-Bllacë dhe rruges per tek varrezat e reja te fshatit Bllacë-Suharekë me numër të prokurimit 624-25-4485-5-1-1.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës:punë, vlera e parashikuar e kontratës: 1,300,000.00 €.

Me 03.07.2025, OE SEFERI-CO SH.P.K., ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 08.07.2025, Autoriteti Kontraktues e ka refuzuar si të pabazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 09.07.2025, OSHP ka pranuar ankesën nga OE SEFERI-CO SH.P.K., me nr. 2025/0624 lidhur me aktivitetin Projekt me bashkfinancim - Ndertimi idevijiit te rruges Magjistrale ne fshatrat Duhël-Bllacë dhe rruges per tek varrezat e reja te fshatit Bllacë-Suharekë me numër të prokurimit 624-25-4485-5-1-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues SEFERI-CO SH.P.K., janë parashtruar si në vijim:

Dispozitat Ligjore dhe Nënligjore të Shkelura Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik (i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjet Nr. 04/L 237, Nr. 05/L-068 dhe Nr. 05/L-092)

Neni 7 – Parimet Themelore të Prokurimit Publik

- 7.1: Prokurimi publik duhet të bazohet në parimet e transparencës, mosdiskriminimit dhe trajtimit të barabartë.
- 7.2: Autoriteti kontraktues nuk duhet të vendosë kërkesa që diskriminojnë ose favorizojnë ndonjë

operator ekonomik në mënyrë të pajustificuar.

- 7.3: AK është i obliguar të sigurojë trajtimin e barabartë dhe jo-diskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë të interesuar.

Neni 59 – Kapaciteti ekonomik, financiar dhe teknik/profesional

- Kriteret për kualifikim duhet të jenë:

- o Të arsyeshme dhe proporcionale me natyrën dhe madhësinë e kontratës; o Të domosdoshme objektivisht për përmbushjen e kontratës;

- o Jo-kufizuese për pjesëmarrjen në mënyrë të panevojshme.

Ndryshimet përmes Ligjit Nr. 05/L-068 • Ky ligj përcakton se Autoritetet Kontraktuese nuk duhet të përdorin kushte të panevojshme, që nuk lidhen drejtëpërdrejt me realizimin e kontratës dhe që mund të kenë efekt kufizues apo diskriminues në konkurrencë.

Rregullorja Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik (e ndryshuar me Rregulloren Nr. 002/2024) Neni 27 – Kushtet për pjesëmarrje • Kushtet për pjesëmarrje duhet të jenë: o Të lidhura drejtëpërdrejt me natyrën dhe objektin e kontratës; o Proporcionale dhe të arsyeshme; o Të mos kërkojnë përvojë të tepërt, certifikata jorelevante apo pajisje jo të nevojshme për përmbushjen e kontratës. Neni 28 – Përshkrimi teknik • Përshkrimi teknik nuk duhet të përmbajë marka tregtare, specifikime të kufizuara, ose referenca të veçanta, përveçse kur kjo është e domosdoshme dhe e arsyetuar qartë nga natyra e kontratës.

KËRKESAT PËR KAPACITETIN FINANCIAR – DISKRIMINUUESE

Kërkesat për qarkullim vjetor financiar shumëfish mbi vlerën e kontratës nuk janë të arsyetuara në raport me objektin dhe madhësinë e kontratës. Mbështetje ligjore: • Neni 59, Ligji Nr. 04/L-042: Kriteret duhet të jenë "të arsyeshme dhe proporcionale me natyrën dhe madhësinë e kontratës." • Neni 27, Rregullorja Nr. 001/2022 (e ndryshuar me 002/2024): Autoritetet kontraktuese nuk duhet të vendosin kërkesa të pajustificuara që kufizojnë konkurrencën.

2. KËRKESAT PËR KAPACITETIN TEKNIK DHE PROFESIONAL

Kushtëzimi për stafin profesional me përvojë të tejzgatur (p.sh. 10 vite), në mungesë të ndonjë analize të justifikueshme, përbën kufizim të panevojshëm dhe diskriminues për OE-të që kanë kapacitet të mjaftueshëm. Mbështetje ligjore: • Neni 7, Ligji Nr. 04/L-042: Prokurimi publik duhet të bazohet në parimet e mosdiskriminimit dhe trajtimit të barabartë. • Udhëzuesi 002/2024: Vlerëson si të paarsyeshme kriteret për stafin që nuk janë të lidhura drejtëpërdrejt me përmbushjen e kontratës.

3. KËRKESAT PËR PAISJE TË VEÇANTA

Përcaktimi i kërkesave për makineri specifike (p.sh. ngarkues 60 ton), që tejkalojnë nevojat reale për kryerjen e punimeve, nuk është i arsyetuar teknikisht dhe kufizon pjesëmarrjen në mënyrë disproporcionale. Mbështetje ligjore: • Neni 28, Rregullorja Nr. 001/2022 (e ndryshuar me 002/2024): Specifikimet teknike duhet të jenë

neutrale dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës. Neni 59 – Përcaktimi i kriterëve për kapacitetin ekonomik, financiar, teknik dhe profesional • Parashikon se kërkesat: o Duhet të jenë të arsyeshme dhe proporcionale me natyrën dhe madhësinë e kontratës. O Nuk duhet të kufizojnë pjesëmarrjen përtej asaj që është domosdoshmëri objektive për realizimin e kontratës.

Kjo kërkesë është diskriminuese, joproporcionale dhe pa arsyetim ligjor bindës. Bazuar në nenin 59 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, Udhëzuesin e KRPP-së Nr. 001/2022 dhe

002/2024, si dhe praktikat e vendimeve të OSHP-së, parashtrojmë këtë kërkesë për rishqyrtim dhe ndryshim të kriterit të vendosur në dosjen e tenderit lidhur me kërkesën për mbështetje bankare në shumën 500,000.00 €.

1. Kërkesa aktuale është joproportionale dhe diskriminuese

Kërkesa për mbështetje bankare me shumë absolute prej 500,000.00 € dhe shpërndarja e saj e detyrueshme që Lideri të mbulojë minimalisht 60%:

- Nuk është e arsyetuar teknikisht, financiarisht dhe ekonomikisht, siç kërkohet nga neni 59.3 i LPP dhe neni 27 i Rregullores 001/2022, duke e bërë atë joproportionale me natyrën dhe madhësinë e kontratës.
- Nuk është ofruar asnjë dokument i analizës së riskut, standard teknik, apo vlerësim I tregut financiar që të mbështesë saktësimin e shumës dhe përqindjes për liderin e grupit.
- Kjo përbën shkelje të nenit 7 të LPP-së, që garanton barazi dhe konkurrencë të ndershme.

2. Kundërthënie me Udhëzuesin e KRPP 002/2024

Sipas nenit 3.3.1 dhe 3.3.2 të Udhëzuesit 002/2024, kërkesat për kapacitet financiar duhet të jenë:

- Të bazuara në analizë të arsyeshme dhe objektive;
- Të ofrojnë alternativa si qasje në linjë krediti të pakushtëzuar, jo vetëm mjete të gatshme;
- Të formuluar në mënyrë neutrale dhe jo-kufizuese.

AK ka dështuar të ofrojë alternativa të pranueshme, duke e shndërruar kërkesën në kriter kufizues, në kundërshtim me nenin 67.6 të LPP-së, që parasheh përjashtim të OE-ve vetëm për mungesë të arsyeshme të kapacitetit, jo për mungesë dokumenti të caktuar në formë rigide.

3. Në kundërshtim me vendimet e OSHP-së

Bazuar në praktikat e vendimeve të OSHP-së:

- Vendimi nr. 2023/0213: Konstatoi se vendosja e shumës së lartë pa analizë është kriter diskriminues.
- Vendimi nr. 2022/0456: Thekson që kriteret financiare duhet të jenë të arsyetuara mbi bazë të riskut të projektit dhe jo mbi supozime të përgjithshme.

AK në këtë rast nuk ka paraqitur asnjë dokument që arsyeton pse për këtë projekt kërkohet mbështetje bankare fikse në vlerë 500,000.00 €, apo pse lideri duhet të mbulojë pikërisht 60%.

4. Kërkesë për ndryshim

Duke u bazuar në argumentet e mësipërme, kërkojmë që Autoriteti Kontraktues të ndryshojë formulimin e kriterit si vijon: Formulimi aktual (për t'u anuluar):

“OE duhet të ketë mbështetje bankare me shumë minimale prej 500,000.00 €, ku lideri duhet të ketë minimum 60% të saj...” Formulim i propozuar (alternativ):

“OE duhet të dëshmojë qasje të garantuar në linjë krediti të pakushtëzuar ose mbështetje financiare nga institucion financiar në vlerë të arsyeshme për realizimin e projektit, pa caktuar përqindje të ndarë për anëtarët e grupit.”

Sipas nenit 7 dhe 59.3 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës (i ndryshuar me Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Nr. 05/L-092), Autoriteti Kontraktues është i obliguar të respektojë parimin e barazisë, mosdiskriminimit, proporcionalitetit dhe konkurrencës së ndershme.

Përgjigja juaj lidhur me kërkesën për mbështetje bankare në shumën prej 500,000.00 € nuk paraqet arsyetim specifik ligjor, teknik apo ekonomik, por bazohet në deklarime të përgjithshme dhe të paanalizuara. Mungon justifikimi konkret mbi natyrën e kontratës, riskun financiar real, dhe nevojën e vërtetuar për vendosjen e kësaj shume të lartë.

2. Shkelje e Udhëzuesit 001/2023 dhe 002/2024 të KRPP

Sipas Udhëzuesit për Prokurim Publik 002/2024, neni 3.3.1 dhe 3.3.2, specifikohet se kriteret për kapacitete financiare duhet të jenë proporcionale me natyrën dhe vlerën e kontratës, Përgjigja juaj nuk ofron mundësi alternative dhe nuk reflekton respektim të udhëzimeve përkatëse. Mosparashikimi i alternativave të pranueshme është në kundërtënie me nenin 67.6 të LPP dhe përfaqëson kriter kufizues.

3. Kundër praktikës së vendimeve të OSHP

Vendimet e OSHP, si:

- vendimi nr. 2023/0213,
- vendimi nr. 2022/0456,

kanë konstatuar se vendosja e shumave të larta pa analizë të justifikuar është diskriminuese dhe e papranueshme.

Kërkesa 2 - Numri i punëtorëve të angazhuar në min. 30 punëtor me të dhënat në vijim Emri, mbiemrin, mosha e punëtorit, profesioni, eksperiencia (vite) dhe pozicioni në kompani. Së paku 5 punëtor te trajnuar për ndihmë të parë., ----- Dëshmia 2 - Lista e numrit të punëtorëve të angazhohen për kryerjen e punëve, min. 30 punëtor me të dhënat në vijim Emri, mbiemrin, mosha e punëtorit, profesioni, eksperiencia (vite), pozicioni në kompani duhet të dorëzohet në origjinal, i nënshkruar dhe i vulosur nga Operatori Ekonomik. Punëtoret duhet te jene te trajnuar dhe te certifikuar për lëmin e sigurisë dhe shëndetit ne pune si dhe te trajnuar dhe te certifikuar për mbrojtjen kundër zjarrit.Licenca nga kompania trajnuese. Këtë projekt, min. 30 punëtor me të dhënat në vijim Emri, mbiemrin, mosha e punëtorit, profesioni, eksperiencia (vite) dhe pozicioni në kompani. (nga 30 puntore prej tyre 8 te jene me certifikata per siguri dhe shendet ne pune si dhe certifikata per mrojte kunder zjarrit, ndersa 2 punetor te jene te trajnuar per ndihm te pare)

Në dokumentin e tenderit (përfshirë edhe përmirësimin me formularin standard të gabimeve), AK ka përcaktuar:

- Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin një listë me minimum 30 punëtorë, me të dhëna të plota;
- 8 prej tyre të jenë të certifikuar për siguri dhe mbrojtje kundër zjarrit;
- 2 prej tyre të jenë të trajnuar për ndihmë të parë.

2. Pyetja e parashtruar nga OE në kërkesën për sqarim:

“A është e domosdoshme që certifikatat për siguri në punë, mbrojtje nga zjarri dhe ndihmë të parë të jenë të lidhura me punëtorë të identifikuar në ofertë, apo mjafton zotimi se ato do të ofrohen gjatë zbatimit të kontratës?”

3. Përgjigjja e dhënë nga Autoriteti Kontraktues:

AK ka deklaruar se kërkesa mbetet në fuqi, pa ofruar arsyetim teknik, ligjor apo praktik, pse certifikatat e trajnimit kërkojnë pikërisht në fazën e ofertimit dhe pse nuk lejohet fleksibiliteti i plotësimit të tyre gjatë zbatimit të kontratës.

4. Vlerësimi ligjor:

Kjo kërkesë është joproporcionale dhe diskriminuese, sepse:

- Kufizon në mënyrë të panevojshme OE-të që kanë kapacitete reale për të trajnuar punonjësit pas lidhjes së kontratës;
- Është në kundërshtim me nenin 7 të LPP-së, që garanton barazi dhe konkurrencë të ndershme;
- Nuk bazohet në nenin 67.6 të LPP-së, i cili kërkon që për kapacitetet e personelit të pranohen më shumë se një formë prove, përfshirë deklaratat e OE-së për zotim të kapaciteteve të nevojshme.

5. Trajtimi i pabarabartë i punëtorëve – ndikimi i brendshëm diskriminues:

Kërkesa, ashtu siç është formuluar, nuk cenon vetëm operatorët ekonomikë, por përbën edhe një trajtim të pabarabartë brenda vetë stafit të punëtorëve:

- Vetëm 8 nga 30 punëtorët duhet të jenë të certifikuar për siguri në punë dhe mbrojtje nga zjarri;
- Vetëm 2 punëtorë duhet të jenë të trajnuar për ndihmë të parë;
- Kjo krijon një ndarje artificiale e të paarsyetuar në funksionet dhe përgatitjen e stafit, dhe cenon barazinë e trajtimit të punëtorëve në ambientin e punës;
- Në realitetin e implementimit, të gjithë punëtorët duhet të jenë të mbrojtur dhe të trajnuar njësoj, sipas Ligjit për Siguri dhe Shëndet në Punë.

Kërkesa, në këtë mënyrë, nuk garanton siguri reale, por vendos një standard të dyfishtë të trajtimit të punonjësve, duke zhvendosur përgjegjësinë e sigurisë në mënyrë selektive dhe jogjithëpërfshirëse.

6. Vendimet përkatëse të OSHP:

Vendime si:

- OSHP nr. 2023/0196
- OSHP nr. 2022/0456

kanë konstatuar se kushtëzimi i stafit me certifikata të veçanta në fazën e ofertimit, pa analizë konkrete dhe pa mundësi fleksibiliteti, përbën shkelje të parimeve themelore të prokurimit dhe është diskriminues.

7. Kërkesë:

Kërkojmë që:

1. AK të anulojë kërkesën për certifikatat dhe trajnimet si kusht në fazën e ofertimit;
2. Të lejojë që këto të dëshmohen gjatë zbatimit të kontratës, me zotim formal të OE-së;
3. Të garantojë që nuk vendos standarde të dyfishta

KËRKESA 3.1 – Menaxheri i Projektit: përvoja dhe certifikata ISO 14731

1. Përmbajtja e kërkesës në dokumentet e tenderit:

Në dokumentet e tenderit është specifikuar se:

“Menaxheri i projektit duhet të jetë Inxhinier i Diplomuar i Ndërtimtarisë ose Master – Drejtimi Konstruktiv, me përvojë pune minimum 10 vite pas diplomimit. I njëjti duhet të jetë i certifikuar me ISO “Welding Supervisor” sipas standardit ISO 14731.”

2. Pyetjet e parashtruara në kërkesën për sqarim:

- a) “Ju lutemi sqaroni nevojën për kërkesën që Menaxheri i Projektit të jetë i certifikuar si ‘Welding Supervisor’ sipas ISO 14731.”
- b) “A është e justifikuar kërkesa për përvojë 10-vjeçare pas diplomimit, apo mund të konsiderohet përvojë menaxheriale 5-vjeçare, siç parashihet zakonisht për këtë nivel?”

3. Përgjigjja e dhënë nga Autoriteti Kontraktues:

AK nuk ka ofruar asnjë arsyetim të detajuar ligjor ose teknik, por ka ripërsëritur se kërkesat mbeten në fuqi, përfshirë:

- Certifikatën ISO 14731 për menaxherin e projektit;
- Përvojë jo më pak se 10 vite pas diplomimit.

4. Vlerësimi ligjor dhe teknik për ISO 14731:

- Certifikata ISO 14731 i referohet mbikëqyrjes së saldimeve teknike në projekte me konstruksione metalike dhe saldim.

- Menaxheri i projektit, si rol drejtues, nuk ka detyra teknike të saldimit, por menaxhon kohë, resurse, planifikim, cilësi dhe raportime.

- Vendosja e kësaj certifikate si kusht i detyrueshëm, pa lidhje me përmbajtjen e rolit, është:

- o E paarsyetuar teknikisht,

- o Në kundërshtim me nenin 7 të LPP-së,

- o Dhe bie ndesh me parimin e proporcionalitetit dhe konkurrencës së ndershme.

5. Vlerësimi për përvojën 10-vjeçare pas diplomimit:

- Kërkesa për 10 vite përvojë është jashtë praktikës së zakonshme për menaxhim projektsh infrastrukturorë të nivelit komunal;

- Nuk është dhënë asnjë analizë për kompleksitetin e projektit që ta justifikojë këtë afat të gjatë;

- Udhëzuesi 002/2024 i KRPP, për kapacitetin profesional, nuk e parashikon si standard kërkesën për përvojë pas diplomimit në periudha fikse të gjata;

- Përvoja 5 vite pas diplomimit është në përputhje me praktikën më të mira për pozitën menaxheriale në projekte publike.

6. Diskriminimi dhe kufizimi i panevojshëm:

- Kërkesa për 10 vite përvojë + një certifikatë shumë specifike teknike (ISO 14731), kombinohen për të përjashtuar shumicën e kandidatëve realisht të kualifikuar;

- Kjo bie në kundërshtim me praktikën e OSHP-së, si p.sh. vendimet:

- o OSHP nr. 2023/0221

- o OSHP nr. 2022/0490

Të cilat theksojnë se:

“Kërkesat e tepërta për përvojë të tejzgatur ose certifikata të specializuara jashtë fushës së rolit përbëjnë kufizim të konkurrencës dhe janë të paarsyetueshme.”

7. Kërkesë për rishqyrtim:

Kërkojmë që AK të:

1. Heqë kërkesën për certifikatën ISO 14731 për Menaxherin e Projektit, ose të pranojë certifikata ekuivalente në fushën e menaxhimit të projekteve;

2. Ulet kërkesa për përvojë pas diplomimit nga 10 vite në minimum 5 vite, siç është praktikë standarde për pozita të ngjashme;

3. Lejojë formë fleksibile dhe të arsyeshme të dëshmisë së përvojës dhe kualifikimeve, në përputhje me nenin 67 të LPP-së dhe udhëzuesit përkatës të KRPP.

KËRKESA 3.2 – Udhëheqësi i Punishtes: certifikatat dhe kërkesa të tepruara

1. Përmbajtja e kërkesës në dokumentin e tenderit:

Në Kërkesën 3.2 të dokumenteve të tenderit, Autoriteti Kontraktues ka përcaktuar që:

“Udhëheqësi i Punishtes duhet të jetë Inxhinier i Diplomuar i Ndërtimtarisë ose Master – Drejtimi Konstruktiv, me përvojë pune minimum 5 vite pas diplomimit. I njëjti duhet të jetë i certifikuar si përgjegjës për:

- Sigurimin dhe kontrollin e mjedisit;
- Sigurinë dhe shëndetin në punë;
- Mbrojtjen kundër zjarrit.”

2. Pyetja e parashtruar nga OE në kërkesën për sqarim:

“A mund të pranohet që certifikatat për siguri në punë, mjedis dhe mbrojtje kundër zjarrit të mbulohen nga persona të ndryshëm në ekip dhe jo domosdoshmërisht nga Udhëheqësi i Punishtes?”

3. Përgjigjja e dhënë nga Autoriteti Kontraktues:

AK është përgjigjur se kërkesa mbetet në fuqi, pa dhënë arsyetim teknik ose ligjor, se përse të gjitha këto certifikata duhet të posedohen vetëm nga një person, përkatësisht nga Udhëheqësi i Punishtes.

4. Vlerësimi ligjor dhe teknik:

Kjo kërkesë është:

- Disproporcionale, sepse ngarkon një pozitë teknike me tri përgjegjësi të ndara ligjore dhe praktike, të cilat në praktikë zakonisht mbulohen nga pozita dhe persona të ndryshëm;
- Diskriminuese, pasi redukton ndjeshëm mundësinë që OE të nominojë profesionistë të kualifikuar sipas realitetit të organizimit të brendshëm;
- Në kundërshtim me nenin 7 të LPP-së, për barazi dhe proporcionalitet;
- Në kundërshtim me nenin 67 të LPP-së dhe udhëzuesin 002/2024, të cilat kërkojnë që kriteret të mos tejkalojnë nevojat reale dhe të jenë të justifikuara.

5. Përmbajtje teknike e tepruar dhe e paarsyetuar:

Certifikatat për:

- Siguri dhe shëndet në punë,
- Mbrojtje kundër zjarrit, dhe
- Menaxhim të mjedisit janë trajtime të ndara, që sipas ligjit përkatës në fuqi (si Ligji për Mbrojtjen nga Zjarri dhe Ligji për Siguri dhe Shëndet në Punë), zakonisht kërkojnë profesionalizëm specifik dhe rol të dedikuar (si

oficer për siguri në punë ose person i certifikuar në mbrojtje nga zjarri), dhe jo patjetër të inkorporohen te udhëheqësi i drejtpërdrejtë i punishtes.

6. Vendimet përkatëse të OSHP-së:

Vendime si:

- OSHP nr. 2022/0590 dhe
- OSHP nr. 2023/0178

kanë konstatuar se:

“Kërkesat për certifikata të shumëfishta të detyrueshme në një person të vetëm, pa opsion që ato të ndahen në ekip, përbëjnë kufizim të panevojshëm dhe nuk pasqyrojnë realitetin teknik të zbatimit të kontratës.”

7. Kërkesë për rishqyrtim:

Kërkojmë që Autoriteti Kontraktues të:

1. Heqë detyrimin që të gjitha certifikatat të posedohen nga vetëm një person (Udhëheqësi i Punishtes);
2. Të lejojë që certifikatat për siguri në punë, mjedis dhe mbrojtje nga zjarri të mbulohen nga personel të ndryshëm në ekipin teknik, siç është praktikë standarde në sektorin ndërtimor;
3. Përmbajtja e kërkesës:

AK kërkon në Kërkesën 3.3 që OE të paraqesë, ndër të tjera:

“Inxhinier i Diplomuar i Hidroteknikës ose Master – me përvojë minimum 10 vite pas diplomimit.”

2. Pyetja e parashtruar në kërkesën për sqarim:

“Ju lutemi sqaroni lidhjen direkte të pozicionit të inxhinierit të hidroteknikës me zbatimin e kësaj kontrate, dhe nëse kjo pozitë justifikohet për shkak të përmbajtjes së punimeve të parapara në paramasë.”

3. Përgjigjja e AK dhe analiza kritike:

Në vend që të japë një analizë teknike të përmbajtjes së kontratës, AK është mbështetur në faktin se “pozitat përfshihen në paramasë” për të justifikuar nevojën për këtë pozitë.

Por në realitet, paramasa për projektin përmban pozita të zakonshme të fushës së ndërtimtarisë rrugore, të tilla si:

- punime në trasa rrugore,
- gjurmime dhe mbushje,
- bordura, rigolla, pusetat, shtresa inerte dhe asfaltuese,
- ndonjë element i thjeshtë i kanalizimit të ujërave atmosferike (nëse ka).

Këto janë të gjitha punime që menaxhohen nga inxhinierë të ndërtimtarisë rrugore apo përgjegjës teknikë të përvojës së zakonshme dhe nuk kërkojnë ekspertizë të thelluar hidroteknike.

4. Kamufli i kriterit joproporcional përmes “leshësive”:

AK ka bërë përpjekje që, përmes referimit të pozitave të zakonshme që figurojnë në paramasë (leshësat), të arsyetojë përfshirjen e një pozicioni të nivelit të lartë, që realisht:

- nuk ka funksion të justifikueshëm në këtë projekt;
- nuk përmendet si nevojë në paramasë, dhe
- nuk lidhet me asnjë pozicion konkret që kërkon mbikëqyrje hidroteknike.

Në këtë mënyrë, është bërë një përpjekje për ta kamufluar një kriter diskriminues, duke e vendosur brenda një strukture që duket “normale”, por në fakt përbën:

- shkelje të nenit 7 të LPP-së,
- mosrespektim të nenit 67.6 të LPP-së, dhe
- cenim të barazisë dhe konkurrencës.

5. Vendime përkatëse të OSHP-së:

Vendimet si:

- OSHP nr. 2022/0611 dhe
- OSHP nr. 2023/0171

theksojnë se:

“Referimi në pozita të zakonshme të zbatimit (leshësa), për të arsyetuar kritere të larta të paarsyetuara profesionale, është teknikë kufizuese që përbën shkelje të nenit 7 të LPP-së.”

6. Kërkesë për rishqyrtim:

Kërkojmë që AK:

1. Të heqë kërkesën për Inxhinier të Hidroteknikës, pasi kjo pozitë nuk është e domosdoshme për natyrën e kontratës;
2. Të mos përdorë pozitat e thjeshta të përfshira në paramasë si bazë për përfshirjen e pozitave të nivelit të lartë që nuk janë funksionalisht të lidhura me to;
3. Të rishikojë dokumentet e tenderit në përputhje me LPP-në dhe Udhëzuesin 002/2024, duke larguar kriteret që nuk bazohen në nevojë teknike reale.

Në pikën 3.4 të kërkesave për kapacitet teknik dhe profesional, AK ka specifikuar:

“Inxhinier i Diplomuar i Ndërtimtarisë ose Master – Drejtimi Konstruktiv, me përvojë pune minimum 5 vite pas diplomimit.”

2. Pyetja e parashtruar në kërkesën për sqarim:

“Ju lutemi të sqaroni funksionin specifik të këtij inxhinieri shtesë të ndërtimtarisë në kuadër të zbatimit të kontratës, duke marrë parasysh se në kërkesat 3.1 dhe 3.2 janë paraparë tashmë Menaxheri i Projektit dhe Udhëheqësi i Punishtes, të dy me kualifikime të plota në ndërtimtari.”

3. Përgjigjja e dhënë nga Autoriteti Kontraktues:

Përgjigjja e AK nuk jep asnjë arsyetim objektiv dhe të mbështetur në analiza teknike. Në vend të kësaj, përgjigjja e AK ka qenë e natyrës së përgjithshme dhe e shmangshme, duke u mbështetur në formulime si:

“Për projektin në fjalë kërkohet të përfshihen në listë personat profesional të përmendur më lartë në kërkesën 3 – për të dëshmuar që posedoni personel të kualifikuar për realizimin e kontratës.”

AK nuk ka treguar konkretisht se:

- Cili është roli specifik i kësaj pozite,
- Çfarë e dallon këtë pozitë nga ato që tashmë janë të parashikuara, dhe
- Për cilat pjesë të projektit është domosdoshmëri kjo pozitë e tretë në ndërtimtari.

4. Vlerësimi dhe kundërshtimi:

Kërkesa për një inxhinier shtesë të ndërtimtarisë, përveç Menaxherit të Projektit dhe Udhëheqësit të Punishtes (të dy gjithashtu inxhinierë ndërtimi), është:

- Pa funksion të qartë dhe të veçuar teknik në raport me dy pozitat ekzistuese;
- E vendosur pa analizë të ngarkesës së punës, numrit të punimeve, vëllimit të detyrave, apo rrezikut teknik që do të kërkonte shtesë të burimeve njerëzore;
- Përgjigjja e dhënë nga AK nuk jep arsyetim specifik, por thjesht përsërit kërkesën – duke dëshmuar mungesë të argumentimit objektiv.

5. Shkelje ligjore dhe mungesë proporcionaliteti:

- Kjo kërkesë bie në kundërshtim me nenin 7 të Ligjit për Prokurimin Publik, sepse vendos kufizim të panevojshëm për operatorët ekonomikë që tashmë kanë strukturë të plotë teknike;
- Nuk përmbush kriteret e nenit 67.6 të LPP-së, sipas të cilit AK duhet të parashohë zgjidhje fleksibile dhe të barabarta për dëshmimin e kapaciteteve;
- Është në kundërshtim me Udhëzuesin 002/2024, i cili kërkon që kërkesat të mbështeten në nevojë reale dhe të jenë të lidhura drejt me objektin dhe kompleksitetin e kontratës.

6. Praktika e OSHP-së:

Vendimet e OSHP-së si:

- OSHP nr. 2023/0208
- OSHP nr. 2022/0504 kanë konstatuar se:

“Përfshirja e pozicioneve shtesë pa funksion të qartë dhe pa diferencim teknik nga pozitat ekzistuese përbën kriter të tepruar, të paarsyetuar dhe diskriminues.”

7. Kërkesë për rishqyrtim:

Kërkojmë që Autoriteti Kontraktues:

1. Të anulojë kërkesën për pozitën shtesë të Inxhinierit të Ndërtimtarisë (Kërkesa 3.4), për shkak se ajo nuk është funksionalisht e dallueshme nga pozitat e parashikuara në 3.1 dhe 3.2;
2. Të sqarojë se çfarë roli specifik ka kjo pozitë në raport me detyrat ekzistuese, nëse insiston në përfshirjen e saj;
3. Të respektojë parimet e proporcionalitetit dhe objektivitetit, në përputhje me LPP dhe udhëzimet e KRPP.

Në pikën 3.8 të kërkesave për kapacitet profesional, Autoriteti Kontraktues kërkon:

“Bachelor i Diplomuar i Ndërtimtarisë / Arkitekturës, i certifikuar me PMP (Project Management Professional), me përvojë pune minimum 8 vite.”

2. Pyetjet e parashtruara nga OE në kërkesën për sqarim:

- a) “Lutemi të sqaroni funksionin konkret të kësaj pozite në raport me projektin dhe rolet ekzistuese të menaxhimit (si p.sh. Menaxheri i Projektit në 3.1).”
- b) “A mund të zëvendësohet certifikata PMP me përvojë ose certifikatë ekuivalente?”
- c) “A mund të kërkohet përvojë më e arsyeshme (p.sh. 3–5 vite), nëse roli është vetëm mbështetës?”

3. Përgjigjja e Autoritetit Kontraktues (faqe 6 e dokumentit të sqarimeve):

“PMP është një certifikim ndërkombëtar për menaxhimin e projekteve që aprovon njohuritë dhe përvojën në drejtimin dhe koordinimin e projekteve ndërtimore.”

“Autoriteti Kontraktues mbetet i angazhuar të sigurojë profesionalizëm, transparencë dhe konkurrencë të drejtë.”

4. Analizë kritike:

Përgjigjja e AK nuk i jep përgjigje asnjërës nga pyetjet thelbësore të OE:

- AK nuk e definon funksionin konkret të pozitës në kuadër të projektit, duke pranuar në mënyrë të tërthortë se pozita ka rol “mbështetës”, jo drejtues;

- Megjithatë, AK kërkon:

- o Certifikatë PMP, e cila është standard për rolet menaxheriale të larta në projekte madhore shumëdisiplinare;

- o Përvojë 8-vjeçare, e barabartë ose më e lartë sesa ajo që kërkohet për Menaxherin e Projektit në 3.1, i cili ka vetëm 10 vite dhe ISO teknike.

Kjo përbën:

- Mospërputhje të brendshme në vetë logjikën e dokumentit të tenderit;

- Kërkesë jo proporcionale me rolin e parashikuar;

- Diskriminim të kandidatëve të rinj profesionalë, të cilët do të mund të mbulonin me sukses një pozitë të mbështetjes teknike ose arkitekturore pa qenë të certifikuar PMP dhe me përvojë 8+ vjeçare.

5. Kundërshtim ligjor dhe teknik:

- Kjo kërkesë bie në kundërshtim me:

- o Nenin 7 të LPP-së për proporcionalitet dhe barazi,

- o Nenin 67.2 dhe 67.6, sepse nuk parashihen forma alternative të pranueshme (si përvojë ekuivalente ose certifikata të tjera relevante), o Udhëzuesin 002/2024, ku thuhet se certifikatat dhe kriteret e përvojës duhet të

reflektojnë nevojën reale teknike të kontratës, dhe jo të jenë standarde absolute pa analizë funksionale.

6. Vendime të OSHP-së me precedent të ngjashëm:

Vendimet si:

- OSHP nr. 2022/0568

- OSHP nr. 2023/0175 kanë konstatuar se:

“Vendosja e certifikatave të avancuara për pozita pa rol menaxhues primar, apo kërkesa të gjata përvojash për pozita mbështetëse, përbëjnë kufizim të panevojshëm të konkurrencës.”

7. Kërkesë për rishqyrtim:

Kërkojmë që AK:

1. Të heqë kërkesën për certifikatën PMP për pozitën në pikën 3.8, si të paarsyetuar për një pozitë jo-menaxheriale;
2. Të zëvendësojë përvojën 8-vjeçare me një kërkesë më të arsyeshme dhe proporcionale (p.sh. 3–5 vite);
3. Të ofrojë arsyetim funksional të rolit që luan kjo pozitë në projekt, ose në të kundërt, të rishikojë tërësisht nevojën për ekzistencën e saj në këtë kontratë.

Në pikën 3.9 të dokumenteve të tenderit, AK ka përfshirë pozitën:

“Pilot i licencuar për dron nga Autoriteti i Aviacionit Civil, për operim me dron të pajisur me sensorë LIDAR, RTK, PPK, etj.”

2. Pyetja e parashtruar në kërkesën për sqarim:

“Ju lutemi sqaroni pse kërkohet pozita për operator droni në këtë projekt dhe në cilat pjesë të paramasës ose të zbatimit teknik parashihet përdorimi i saj.”

3. Përgjigjja e dhënë nga Autoriteti Kontraktues (referuar faqes 6–7 të dokumentit të sqarimeve):

“Kjo pozitë është instrument i rëndësishëm për mbikëqyrje të kontinuitetit, duke përfshirë vlerësimin gjeometrik dhe përputhshmërinë e objekteve ndërtimore me observime 3D me anë të dronit...”

“Përdorimi i kësaj teknologjie i kontribuon kontrollit të cilësisë dhe verifikimit të terrenit, në përputhje me ligjet në fuqi.”

4. Vlerësimi i përgjigjes dhe analizë kritike:

Kjo përgjigje përbëhet vetëm nga formulime të përgjithshme dhe përshkrime teorike të teknologjisë së dronëve, por:

- Nuk tregon në asnjë vend në paramasë apo plan zbatimi ku është paraparë përdorimi i dronit;
- Nuk lidhet me asnjë pozicion konkret të punimeve (gërmim, asfaltim, kubëzime, kanale, etj.), për të cilat mund të nevojitej observimi 3D;
- Nuk sqaron pse nuk është e mjaftueshme shfrytëzimi i konsulencës ose shërbimit të jashtëm të matjes me dron nëse ka nevojë, në vend që të imponohet një pozitë e brendshme e licencuar në kuadër të OE-së;

- Përdor ligje dhe standarde në mënyrë deklarative, pa bërë lidhje të drejtpërdrejtë të domosdoshmërisë së kësaj pozite me realizimin e kontratës.

5. Mospërputhje me LPP dhe Rregulloren 002/2024:

Kjo kërkesë është në kundërshtim të drejtpërdrejtë me:

- Nenin 7 të Ligjit për Prokurimin Publik, i cili përcakton se kriteret duhet të jenë të nevojshme, proporcionale dhe të arsyetuara;
- Nenin 67.2 dhe 67.6 të LPP-së, ku kërkohet që kërkesat për staf teknik të jenë në funksion të objektit të kontratës dhe të kenë alternativa;
- Rregulloren 002/2024, që saktëson se:

“AK nuk duhet të vendosë kritere të caktuara për personel profesional nëse funksioni i tyre nuk është i lidhur drejtpërdrejt me përmbushjen e kontratës.”

AK në këtë rast nuk ka qenë në gjendje të argumentojë pse kjo pozitë është “domosdoshmërisht” e nevojshme dhe nuk ka ofruar asnjë alternativë teknike, siç e obligon Rregullorja e ndryshuar.

6. Vendime të OSHP-së për raste të ngjashme:

Vendimet si:

- OSHP nr. 2022/0611
- OSHP nr. 2023/0122 kanë theksuar se:

“Përdorimi i referencave të përgjithshme ligjore dhe teknike pa lidhje me përmbajtjen e kontratës dhe pa përfshirje në paramasë, përbën shkelje të parimeve të LPP-së dhe diskriminim teknik.”

7. Kërkesë për rishqyrtim:

Kërkojmë që Autoriteti Kontraktues:

1. Të heqë kërkesën për pozitën “Pilot i licencuar për dron”, si të paarsyetuar dhe të jashtëligjshme në këtë projekt konkret;
2. Të ofrojë arsyetim të plotë teknik, të lidhur me pozicionet në paramasë, nëse insiston në përfshirjen e kësaj pozite;
3. Të respektojë në mënyrë të qartë nenin 67 të LPP-së dhe Rregulloren 002/2024, për për zgjedhjen e kërkesave vetëm kur janë objektivist të nevojshme.

Në kuadër të kërkesave për kapacitet teknik (Kërkesa 4), AK ka përcaktuar që:

“OE duhet të jetë i pajisur me certifikatën ISO SA 8000:2014 (Çertifikata).”

2. Pyetja e parashtruar në kërkesën për sqarim:

“Ju lutemi sqaroni për çfarë arsye kërkohet certifikata ISO SA 8000:2014 në këtë aktivitet prokurimi, si dhe lidhjen e saj me objektin e kontratës.”

3. Përgjigjja e dhënë nga AK (referuar dokumentit të sqarimeve, faqja 7):

AK ka deklaruar se:

“ISO SA 8000:2014 shërben si instrument për të shmangur punën e padeklaruar, diskriminimin e punëtorëve dhe shkeljet e të drejtave në vendin e punës...” “... kjo certifikatë shërben si garanci shtesë ndaj zbatimit të legjislacionit vendor...”

4. Përgjigjja e dhënë nga AK është e paarsyetuar teknikisht, juridikisht dhe logjikisht, sepse:

- Çështjet që lidhen me:

- o Punën e padeklaruar,

- o Diskriminimin në vendin e punës, dhe

- o Respektimin e të drejtave të punëtorëve janë të rregulluara nga Ligji i Punës i Kosovës, dhe kompetencë e Inspektoratit të Punës dhe organeve ligjzbatuese publike, e jo e një standardi privat.

- AK, në pamundësi për të argumentuar domosdoshmërinë e kësaj certifikate në raport me natyrën e kontratës (projekt ndërtimi), ka dhënë arsytim të përgjithshëm dhe jashtë kompetencës, duke e paraqitur ISO SA 8000 si një lloj "garantie" për zbatimin e ligjit – gjë që është jo vetëm jo-logjike, por edhe jokushtetuese.

- Në të njëjtën përgjigje, AK thotë se certifikata është garanci shtesë, ndërsa më lart i jep asaj funksione ligjore mbikëqyrëse, duke krijuar një kontradiktë të brendshme logjike.

5. Kundërshtim ligjor dhe rregullator:

Kjo kërkesë bie në kundërshtim me:

- Nenin 7 të LPP-së për proporcionalitetin dhe barazinë;

- Nenin 59.3 të LPP-së, që thotë se AK nuk duhet të vendosë kritere që kufizojnë pjesëmarrjen në mënyrë të paarsyetuar;

- Nenin 67.6 të LPP-së, i cili e detyron AK të ofrojë alternativa për vërtetimin e kapaciteteve teknike;

- Rregulloren 002/2024, e cila në mënyrë të qartë thekson:

“Çdo kërkesë për standarde apo certifikata duhet të ketë lidhje funksionale dhe të drejtëpërdrejtë me objektin e kontratës dhe të jetë në përputhje me legjislacionin vendor në fuqi.”

AK në këtë rast ka tejkaluar kompetencat e tij, duke e shndërruar një standard vullnetar në një mjet për zbatimin e ligjeve shtetërore, gjë që përbën shkelje materiale të parimeve të prokurimit.

6. Vendime të OSHP-së për raste të ngjashme:

Vendimet si:

- OSHP nr. 2022/0587, dhe
- OSHP nr. 2023/0141 kanë theksuar:

“Kërkesat për certifikata që nuk kanë lidhje të drejtpërdrejtë teknike ose që mbivendosen me detyra të organeve ligjzbatuese përbëjnë kufizim artificial dhe janë të paarsyetuara.”

7. Kërkesë për rishqyrtim:

Kërkojmë që AK:

1. Të anulojë kërkesën për ISO SA 8000:2014, si të paarsyetur dhe në kundërshtim me LPP;
2. Të ndalojë praktikën e zhvendosjes së përgjegjësiave ligjore publike (si mbikëqyrja e punës) te operatorët ekonomikë përmes standardeve vullnetare;
3. Të respektojë nenin 67 të LPP-së dhe Rregulloren 002/2024, duke vendosur vetëm kritere që janë teknikisht të lidhura dhe të justifikuara me objektin e kontratës.

Autoriteti Kontraktues ka kërkuar që Operatorët Ekonomikë të jenë të pajisur me:

“ISO 28001:2007 – Sistem për menaxhimin e sigurisë në zinxhirin e furnizimit.”

2. Pyetja e parashtruar nga OE në kërkesën për sqarim:

“Lutemi të sqaroni se cila është lidhja e standardit ISO 28001:2007 me natyrën dhe përmbajtjen e kësaj kontrate (punime infrastrukturore rrugore), dhe në cilat pjesë të paramasës apo të objektit teknik është paraparë nevoja për sistem të menaxhimit të zinxhirit të furnizimit që do ta arsyetonte kërkesën për këtë standard.”

3. Përgjigjja e dhënë nga AK:

“ISO 28001:2007 është një standard ndërkombëtar që përcakton kërkesat për sistemin e menaxhimit të sigurisë në zinxhirin e furnizimit dhe i kontribuon kontrollit të qasjes së palëve të treta, transportit dhe hyrje-daljeve të mjeteve në kantier.”

4. Kjo përgjigje është e përgjithshme dhe nuk jep asnjë referencë konkrete në dokumentacionin teknik apo në paramasë të projektit. Në mënyrë më specifike:

- Kontrata në fjalë ka karakter lokal, për ndërtimin e një devijimi rrugor në Komunën Suharekë, dhe nuk përmban:

- o Pjesë logjistike me rrezik të lartë,

- o Operacione ndërkufitare të furnizimit,

- o Depo, terminale doganore apo rrjete ndërkombëtare të shpërndarjes.

- Për pasojë, nuk ekziston asnjë justifikim teknik që të kërkohet implementimi i një sistemi të sigurisë për zinxhirin e furnizimit, as për nga natyra e projektit, as për nga rreziku, as për nga dimensionin.

5. AK nuk ka qenë në gjendje të lidhë këtë standard me përmbajtjen reale të kontratës, por ka përdorur formulime të përgjithshme që përshkruajnë standardin në mënyrë teorike, pa e justifikuar në asnjë moment:

- Pse është ky standard i domosdoshëm për një projekt lokal, dhe
- Pse kërkohet për të gjithë operatorët, pavarësisht nga mënyra se si ata menaxhojnë procesin e furnizimit.

6. Kundërshtim me LPP dhe Rregulloren 002/2024:

Kjo kërkesë është në kundërshtim me:

- Nenin 7 të Ligjit për Prokurimin Publik, i cili kërkon proporcionalitet dhe ndalim të diskriminimit;
- Nenin 67.6, i cili e obligon AK të dëshmojë nevojën objektive për çdo certifikatë ose kërkesë dhe të ofrojë forma alternative për dëshmimin e kapaciteteve;
- Rregulloren 002/2024, që parashikon se:

“Certifikatat ISO mund të kërkohen vetëm nëse janë të lidhura drejt dhe funksionalisht me përmbushjen e kontratës dhe objektin e saj.”

Në këtë rast, për një projekt lokal me zinxhir furnizimi standard të materialeve ndërtimore nga tregu vendor, kërkesa për këtë standard është e paarsyetuar, joproporcionale dhe selektive.

7. Vendime të OSHP-së të aplikueshme:

- OSHP nr. 2022/0512,
- OSHP nr. 2023/0190, të cilat theksojnë:

“Kërkesat për standarde të nivelit të lartë ndërkombëtar pa lidhje të drejtëpërdrejtë me kontratën, sidomos në projekte lokale, janë në kundërshtim me LPP dhe përbëjnë pengesë për konkurrencë.”

8. Kërkesë për rishqyrtim:

Duke qenë se:

- Projekti është i thjeshtë dhe lokal;
- AK nuk ka dhënë arsyetim funksional apo teknik për këtë standard;
- Dhe standardi në fjalë nuk lidhet me përmbajtjen e kontratës;

Kërkojmë që:

1. Të anulohet kërkesa për ISO 28001:2007 nga dosja e tenderit;
2. Të rishikohen të gjitha certifikatat e kërkuara sipas natyrës së projektit dhe standardit të nevojshëm të zbatimit, në përputhje me nenin 67 të LPP-së dhe Rregulloren 002/2024;

3. Të shmangen përfshirjet e standardeve të panevojshme që përcaktojnë barriera jo të justifikuara për OE të kualifikuar.

Në Kërkesën 4 për certifikata teknike, Autoriteti Kontraktues ka kërkuar:

“Certifikata ISO 3834-2:2021 – për proceset e saldimit (Welding Quality Requirements).”

2. Pyetja e parashtruar nga OE në kërkesën për sqarim:

“Lutemi të sqaroni nëse në kontratën në fjalë parashihen elemente strukturore që kërkojnë saldim të certifikuar sipas ISO 3834-2, dhe nëse po, në cilat pozicione të paramasës kjo nevojë është specifikuar?”

3. Përgjigjia e dhënë nga AK (faqja 7 e dokumentit të sqarimeve):

AK ka deklaruar:

“Megjithëse nuk janë të detajuara si struktura të mëdha në paramasë, këto elemente mund të përfshijnë mbrojtëse rrugore...”

Dhe më poshtë:

“Kjo kërkesë nuk ndalon pjesëmarrjen në procedurë, pasi operatorët mund të bashkëpunojnë me nënkontraktorë të certifikuar.”

Dhe në vazhdim:

“Certifikata kërkohet në rastet kur gjatë ekzekutimit paraqiten nevoja për saldim... nëse OE nuk kryen vetë saldimet, atëherë nuk është e nevojshme që ta ketë certifikatën.”

4. Përgjigjia e AK është:

- Kontradiktore në vetvete – sepse fillimisht thotë që “mund” të nevojitet për “mbrojtëse rrugore”, që nuk janë të detajuara në paramasë;
- Pastaj pohon që kërkesa nuk ndalon pjesëmarrjen, por lejon bashkëpunim me nënkontraktorë – duke e transformuar një kërkesë që supozohet si e detyrueshme në një mundësi fakultative;
- Së fundi pranon që nëse OE nuk bën vetë saldimet, atëherë nuk ka nevojë për certificate fare – gjë që tregon se kërkesa është e paqëndrueshme dhe jo ligjërish e qartë.

Kjo mënyrë e formulimit dhe arsyetimit i jep kësaj pike karakter të paqëndrueshëm ligjërish, duke e shndërruar në:

- Kriter të paqartë dhe të debatueshëm për interpretim;
- Shkak për ngarkesë të panevojshme administrative për OE;
- Element që nuk përmbush standardin e saktësisë dhe objektivitetit të kërkuar nga Ligji për Prokurim Publik dhe udhëzuesit përkatës.

5. Kundërshtim me LPP dhe Rregulloren 002/2024:

- Kjo kërkesë bie në kundërshtim me:

- o Nenin 7 të LPP-së, për shkak se nuk është as e qartë, as proporcionale dhe as e nevojshme në mënyrë të dëshmuar;

- o Nenin 59.3 të LPP-së, sepse e vendos barrën e certifikimit për një nevojë që vetë AK pranon se “mund” të paraqitet;

- o Nenin 67.6, sepse nuk ofrohet alternativë formale, por përcillet pasiguri që ngarkon OE me rreziqe në interpretim;

- o Rregulloren 002/2024, ku saktësohet se çdo kërkesë duhet të jetë:

“Objektivisht e nevojshme, e qartë dhe e lidhur me përmbajtjen teknike të kontratës, dhe jo deklarative ose e kushtëzuar me supozime.”

6. Vendime të OSHP-së me raste të ngjashme:

Vendimet:

- OSHP nr. 2022/0601, dhe

- OSHP nr. 2023/0207 kanë konstatuar se:

“Kriteret që bazohen në mundësi hipotetike (‘mund të jetë e nevojshme’, ‘nëse paraqitet rast’) nuk përmbushin standardin e përcaktimit të qartë dhe proporcionalitetit.”

7. Kërkesë për rishqyrtim:

Kërkojmë që Autoriteti Kontraktues:

1. Të heqë kërkesën për ISO 3834-2:2021, për shkak të pasigurisë së përmendur në vetë

përgjigjen e dhënë dhe mungesës së mbështetjes në paramasë;

2. Ose në minimum, të sqarojë në mënyrë të prerë nëse është apo jo kërkesë detyruese për OE, dhe në cilat pozita konkrete lidhet nevoja për këtë standard;

3. Të rishikojë dokumentin në përputhje me nenin 67 të LPP-së dhe Rregulloren 002/2024, për të garantuar kërkesa të qarta, proporcionale dhe të arsyetuara.

Në kuadër të kërkesave për kapacitet teknik (Kërkesa 4), AK ka kërkuar:

“Operatori Ekonomik duhet të jetë i pajisur me certifikatën ISO 1452-1:2009.”

2. Rreth standardit ISO 1452-1:2009:

Ky standard i referohet:

“Sistemeve të tubave plastike për furnizim me ujë (pijshëm dhe teknik) dhe kanalizim me presion – pjesa 1: Përgjithësime dhe udhëzime të përgjithshme.”

Ai zbatohet zakonisht për:

- Instalim të rrjeteve të ujësjellësit me presion,
- Sisteme kanalizimi të ujërave të zeza dhe të bardha në presion.

3. Pyetja e parashtruar në kërkesën për sqarim:

“Lutemi të sqaroni lidhjen funksionale të ISO 1452-1:2009 me objektin e kontratës ‘Ndërtimi i devijimit të rrugës magjistrale Duhël–Bllacë’, dhe nëse kjo ISO ka lidhje me ndonjë pozicion të përmendur në paramasë.”

4. Përgjigjia e AK (referuar faqes 7 të dokumentit të sqarimeve):

AK nuk ka dhënë ndonjë përgjigje të qartë funksionale, por është mbështetur në fraza të përgjithshme si:

“Kjo ISO lidhet me cilësinë e materialeve dhe siguron pajtueshmëri me standarde për sisteme plastike me presion.”

Por në asnjë vend të paramasës nuk përmendet ndonjë sistem me tuba plastike në presion, as rrjet ujësjellësi, as kanalizim.

5. Kërkesa për këtë certifikatë:

- Nuk është në përputhje me objektin e kontratës që ka të bëjë me punime rrugore, dhe jo me rrjete furnizimi me ujë;
- Nuk përmendet në paramasë ndonjë komponent teknik që të justifikojë kërkesën për këtë standard;
- Përbën një mbingarkesë teknike të panevojshme, e cila e tejkalon objektin real të kontratës dhe rrit barrën për OE pa efekt në cilësi.

6. Kundërshtim me LPP dhe Rregulloren 002/2024:

- Neni 7 i LPP-së kërkon që kriteret teknike të jenë të justifikuara dhe të ndërlidhura me kontratën;
- Neni 67.6 i LPP-së e obligon AK që të ofrojë alternativa, por në këtë rast nuk ka as alternativë e as lidhje;
- Rregullorja 002/2024 e ndalon përdorimin e standardeve që nuk janë të lidhura funksionalisht me përmbushjen e kontratës.

7. Vendime të OSHP-së për raste të ngjashme:

Vendimet si:

- OSHP nr. 2023/0188 dhe
- OSHP nr. 2022/0549 kanë konstatuar se:

“Vendosja e standardeve teknike që nuk pasqyrojnë objektin real të kontratës është diskriminuese dhe përbën kriter artificial.”

8. Kërkesë për rishqyrtim:

Kërkojmë që Autoriteti Kontraktues:

1. Të heqë kërkesën për ISO 1452-1:2009, si të paarsyetuar për një projekt që nuk përfshin sisteme plastike me presion për ujë apo kanalizim;
2. Të sigurojë që në të ardhmen kërkesat për certifikata të jenë të bazuar në përmbajtjen reale të kontratës, jo në përshkrime të përgjithshme;
3. Të përmbushë detyrimin ligjor sipas nenit 67 të LPP-së dhe Rregullores 002/2024, duke respektuar proporcionalitetin dhe nevojën reale teknike.

Autoriteti Kontraktues ka vendosur si kërkesë teknike:

“Operatori Ekonomik duhet të jetë i pajisur me certifikatën BS EN 13331-1:2002.”

Ky standard lidhet me:

“Sisteme për mbrojtjen e gropave të hapura në tokë (shoring systems), për stabilizimin e anëve të gërmimeve në thellësi.”

2. Pyetjet e parashtruara nga OE në kërkesën për sqarim (të cituara):

1. Cilat pjesë të paramasës apo specifikimeve teknike në këtë kontratë kërkojnë përdorimin e strukturave mbrojtëse sipas BS EN 13331-1:2002?
2. A janë planifikuar gërmime të thella ose pranë objekteve të ndjeshme që kërkojnë përdorimin e paneleve mbrojtëse ose elementeve të përkohshme mbajtëse që justifikojnë këtë certifikatë?
3. Nëse jo, a është kjo kërkesë në përputhje me nenin 7 dhe 59 të LPP-së dhe me nenin 19.2 të Rregullores Nr. 001/2022 të ndryshuar me 002/2024?

3. Përgjigjja e AK:

Në vend të përgjigjes teknike, AK është mbështetur në deklaratën:

“Pozitat përkatëse janë të përfshira në leshësa.”

Por AK nuk ka treguar:

- Pozicionin konkret në paramasë që lidhet me shoring systems;
- Asnjë analizë për gërmime të thella apo situata me rrezik rrëshqitjeje që do ta justifikonin këtë standard.

4. Vlerësimi ligjor dhe teknik:

- Termi “leshësa” nuk përbën referencë teknike ose përgjigje të mjaftueshme;

- Në paramasë nuk ekzistojnë pozita që kërkojnë struktura mbrojtëse për gjurmime;
- Kjo kërkesë është në kundërshtim me nenin 7 dhe 59.3 të LPP-së dhe nenin 19.2 të Rregullores 002/2024, që kërkojnë lidhje funksionale ndërmjet standardit të kërkuar dhe përmbajtjes së kontratës.

5. Kërkesë:

Bazuar në sa më sipër, dhe duke marrë parasysh që Autoriteti Kontraktues nuk ka arritur të japë përgjigje teknike, të saktë dhe të arsyetuar, kërkojmë që:

Të largohet kërkesa për BS EN 13331-1:2002 nga dokumentet e tenderit, për shkak se:

- Nuk është e reflektuar në pozicionet e punimeve;
- Nuk është justifikuar teknikisht;
- Është e vendosur në kundërshtim me legjislacionin në fuqi për prokurim publik.

AK ka kërkuar që Operatorët Ekonomikë të posedojnë:

“Kokë tërheqëse me kapacitet të tërheqjes min. 26 ton.”

2. Pyetjet e parashtruara nga OE në kërkesën për sqarim (të cituara saktësisht):

1. Cili është funksioni specifik i kokës tërheqëse me peshë minimale 26 ton në kuadër të kësaj kontrate, dhe për cilat pozita të punimeve në paramasë është e domosdoshme përdorimi i saj?
2. A ekziston ndonjë punim që kërkon transport me gjysmë-rimorkio të ngarkesave të rënda, ku një kokë tërheqëse me peshë nën 26 ton nuk do të ishte e mjaftueshme teknikisht?
3. A mund të përmbushet funksionaliteti i kësaj kërkesë me mjete alternative të regjistruara për transport të ngarkesave të rënda që janë më fleksibile ose më të zakonshme në praktikën ndërtimore për projekte të kësaj natyre?
4. A është vendosur kjo kërkesë në përputhje me nenin 7 të LPP-së dhe nenin 19.2 të Rregullores Nr. 001/2022 të ndryshuar me 002/2024, që përcaktojnë se kriteret teknike duhet të jenë të lidhura drejtpërdrejt me objektin e kontratës dhe të justifikohen teknikisht?

3. Mungesa e përgjigjes për pikën 1 dhe përgjigje jo objektive për të tjerat:

- AK nuk ka dhënë asnjë përgjigje për pyetjen e parë, që është thelbësore për të kuptuar lidhjen konkrete të mjetit me kontratën;
- Për pyetjet e tjera, AK ka deklaruar në mënyrë të përgjithshme se në “leshësa”, dhe në pozita që përfshijnë “kapakë, kokë hyrëse, elemente masive”, kjo pajisje konsiderohet si “e vetmja teknologji adekuate” – por pa dhënë asnjë analizë të saktë teknike;
- Për më tepër, është referuar edhe te pajisje të tjera të rënda, për të cilat:

o Ose nuk ka dhënë përgjigje fare, ose

o Përgjigjet janë të mangëta.

4. • Në dokumentacionin teknik dhe paramasë nuk figuron ndonjë pozicion konkret që kërkon transport të pajisjeve apo elementeve me peshë që justifikojnë një kokë tërheqëse 26 ton;

• Përgjigja e AK përbëhet vetëm nga formulime të përgjithshme dhe etiketim i mjeteve si “të vetmet adekuate”, pa analizë objektive krahasimore;

• Nuk përmendet asnjë specifikim për ngarkesën, gjatësinë, distancën e transportit, apo për arsye sigurie.

5. Mospërputhje me ligjin dhe rregulloret:

Kjo kërkesë:

• Shkel nenin 7 të LPP-së, për shkak se nuk është proporcionale dhe kufizon pjesëmarrjen pa bazë teknike;

• Nuk përmbush nenin 67.6 të LPP-së, pasi nuk janë ofruar alternativa si nënkontraktim apo mjete ekuivalente;

• Nuk respekton nenin 19.2 të Rregullores 002/2024, që kërkon lidhje të drejtëpërdrejtë ndërmjet kërkesës dhe përmbajtjes së kontratës.

6. Kërkesë për rishqyrtim:

Kërkojmë që Autoriteti Kontraktues:

• Të largojë kërkesën për kokë tërheqëse 26 ton, për shkak se:

o Nuk është përkrahur me përgjigje për pyetjen themelore të OE;

o Nuk është arsyetuar teknikisht në raport me kontratën;

o Përfaqëson një kufizim të panevojshëm dhe të padrejtë ndaj konkurrencës.

Në dokumentet e tenderit, Autoriteti Kontraktues kërkon që Operatorët Ekonomikë të posedojnë:

“Gjysmërimorkio me kapacitet ngarkese prej 65–70 ton.”

2. Pyetjet e parashtruara nga OE në kërkesën për sqarim (të cituara):

1. A ka të bëjë kjo kërkesë me peshën e përgjithshme të mjetit (kokë tërheqëse + rimorkio + ngarkesë) apo me kapacitetin teknik të ngarkesës së lejuar të gjysmë-rimorkios veçmas?

2. A është bërë ndonjë vlerësim i nevojës teknike që justifikon kërkesën për mjete transportuese me kapacitet kaq të lartë, duke marrë parasysh që një pjesë e konsiderueshme e materialeve në paramasë është standarde për ndërtim rrugor dhe zakonisht e trajtuar me mjete konvencionale transporti?

3. Nëse parashihet transport i materialeve me peshë të tillë, a duhet OE të planifikojë pajisje shoqëruese për tejkalim të peshës sipas legjislacionit të transportit rrugor (p.sh. leje speciale

transporti)?

3. Përgjigja e dhënë nga AK – :

AK jep një përgjigje kontradiktore që përbëhet nga dy pjesë që bien ndesh me njëra-tjetrën:

- Fillimisht shkruan se:

“Kapaciteti i kërkuar nënkupton kapacitetin total të transportit të kombinuar të mjetit (kokë + rimorkio + ngarkesë)”,

- Më pas vazhdon me një formulim që e përmbys këtë deklaratë:

“Pra nuk bëhet fjalë për peshën e mjetit si objekt, por me aftësinë e certifikuar transportuese në peshë bruto – për të transportuar mjete të tjera të rënda, p.sh. ekskavator 50–65 ton.”

Ky arsyetim përmban disa probleme serioze:

Kontradiktë logjike: Nëse kërkesa lidhet me “peshën e kombinuar bruto” të mjetit, atëherë nuk ka asnjë lidhje funksionale me transportimin e një pajisjeje të veçantë prej 50–65 ton, pasi vetë mjeti + rimorkio + ekskavatori do e tejkalonin këtë kapacitet.

Mungesë përputhjeje me legjislacionin për transport: Nëse mjeti duhet të transportojë ekskavator 50–65 ton, atëherë duhet të parashihen edhe:

- Leje speciale për tejkallim të peshës në rrugë,
- Shoqërim i posaçëm për tejkallim, dhe
- Vlerësim i profilin të rrugës, të cilat nuk përmenden fare.

Mungesë referencash në paramasë: Në dokumentet e tenderit, nuk ka asnjë pozicion të tillë në paramasë që kërkon transport të pajisjeve me peshë 50–65 ton. Kjo peshë nuk përmendet as në specifikime teknike.

4. Vlerësim ligjor dhe përputhje me LPP:

- Kërkesa është në kundërshtim me nenin 7 të LPP-së, për shkak se nuk është as proporcionale dhe as e qartë;
- Shkel nenin 67.6 të LPP-së, sepse nuk ofron alternativa teknike të pranueshme dhe imponon vetëm një lloj mjeti specifik;
- Nuk përputhet me nenin 19.2 të Rregullores 002/2024, e cila kërkon:

“Kriteret teknike të pajisjeve duhet të jenë të lidhura drejt me përmbajtjen e kontratës dhe të justifikohen teknikisht.”

5. Përgjigja e dhënë nga AK për këtë kërkesë tregon pamundësinë për të ndërtuar një arsyetim objektiv dhe logjik, si dhe mungesë transparence teknike, duke e kthyer këtë kriter në pengesë artificiale për konkurrencë të ndershme.

6. Kërkesë për rishqyrtim:

Kërkojmë që Autoriteti Kontraktues të largojë kërkesën për gjysmërimorkio 65–70 ton, sepse:

- Kërkesa është e paarsyetuar teknikisht;
- Përgjigja e dhënë është kontradiktore, jo-logjike dhe e vetë-rrëzuar në përmbajtje;
- Nuk përmbush as kriterin e proporcionalitetit ligjor, as atë të përputhshmërisë teknike, siç kërkohet nga LPP dhe Rregullorja 002/2024.

Pika 8 – Mungesë përgjigjeje për kërkesat për sqarim mbi pajisjet diskriminuese dhe përgjigje të përgjithësuara nga AK

1. Në kërkesën tonë për sqarim, kemi parashtruar pyetje të qarta dhe të ndara për secilën prej pajisjeve dhe kërkesave teknike të dyshimta, të cilat:

- Nuk lidhen me natyrën e kontratës (punime infrastrukturore rrugore lokale);
- Nuk përmbahen në paramasë;
- Nuk janë të justifikuara në raport me vlerën dhe përmbajtjen e punimeve;
- Përbëjnë kritere të panevojshme, të cilat mund të rezultojnë në përjashtim artificial të operatorëve të kualifikuar.

2. Sjellja e AK në përgjigje të kërkesës për sqarim:

- AK nuk ka ofruar përgjigje individuale për secilën nga pikat e ngritura në kërkesën për sqarim;
- Në vend të kësaj, është ofruar një paragraf i përgjithësuar, në të cilin:

o Përmendet rëndësia e profesionalizmit;

o Justifikohen kërkesat me nevojën për cilësi dhe zbatim të kontratës;

o Nuk përmenden fare mjetet dhe pajisjet specifike të kontestuara, si:

? gjysmërimorkio 65–70 ton,

? kokë tërheqëse 26 ton,

? ISO të panevojshme,

? vinça, drone, etj.

3. Kjo mënyrë e përgjigjes është në kundërshtim të qartë me ligjin dhe praktikën e rregullt të prokurimit publik:

- Neni 49.2 i LPP-së e obligon AK të japë përgjigje të saktë, të qartë dhe në mënyrë të plotë, për secilën kërkesë të sqarimit të parashtruar nga OE;
- Përgjigja e përgjithësuar nuk e plotëson këtë kriter dhe lë pa trajtuar çështje thelbësore që lidhen me konkurrencën dhe barazinë;

- Neni 7 i LPP-së ndalon vendosjen e kriterëve që kufizojnë pjesëmarrjen pa bazë funksionale;
- Neni 67 i LPP-së kërkon që çdo kërkesë teknike të jetë e nevojshme për përmbushjen e kontratës;
- Neni 19.2 i Rregullores 002/2024 e detyron AK që:

“Të përshkruajë me saktësi lidhjen ndërmjet kërkesës teknike dhe përmbajtjes së kontratës.”

Në këtë rast, AK ka shmangur sqarimin real të çështjeve thelbësore, duke lënë të papërgjigjura kërkesa për:

- Justifikimin teknik të pajisjeve;
- Përcaktimin e lidhjes së tyre me paramasën;
- Përputhshmërinë me objektin dhe vlerën e kontratës.

4. Kërkesë për rishqyrtim:

Kërkojmë që Autoriteti Kontraktues:

1. Të rishqyrtojë të gjitha pajisjet dhe kërkesat teknike për të cilat nuk ka dhënë përgjigje të veçanta, por i ka përmbledhur në mënyrë të përgjithshme dhe deklarative;
2. Të përmbushë detyrimin e tij ligjor për kthimin e përgjigjeve të qarta dhe të argumentuara, siç kërkohet me nenin 49.2 të LPP-së;
3. Të rishikojë dokumentet e tenderit dhe të largojë çdo kërkesë që nuk bazohet në dokumentacionin teknik të kontratës, në përputhje me nenin 67 të LPP-së dhe Rregulloren 002/2024.

Në Aneksin 8, Pika 9 të dosjes së tenderit, AK ka kërkuar:

“Ekskavator për gërmim me peshë mbi 50 ton.”

2. Pyetjet zyrtare të parashtruara nga OE në kërkesën për sqarim:

1. Cilat janë pozitat specifike të punimeve në paramasë që kërkojnë përdorimin e një ekskavatori me kapacitet mbi 50 ton, dhe përse nuk mund të përmbushen këto punime me ekskavatorë të klasave 20–40 ton, të cilët përdoren zakonisht për këto qëllime?
2. A është bërë ndonjë vlerësim i natyrës së terrenit (p.sh. prani e shkëmbit, ngurtësi e lartë) që kërkon ekskavator me peshë mbi 50 ton si domosdoshmëri teknike?
3. A është kjo kërkesë në përputhje me nenin 7 dhe nenin 59 të LPP-së, si dhe me nenin 19.2 të Rregullores Nr. 001/2022 të ndryshuar me 002/2024, që kërkojnë që kriteret teknike të jenë të lidhura drejtpërdrejt me objektin e kontratës dhe të jenë të justifikuara teknikisht?

3. Përgjigja e AK dhe analiza kritike:

AK nuk ka ofruar ndonjë përgjigje të drejtpërdrejtë, teknike ose të mbështetur në dokumentacion, për asnjërën nga pyetjet e mësipërme.

- Nuk ka identifikuar ndonjë pozicion konkret në paramasë që kërkon ekskavator me peshë mbi 50 ton;
- Nuk ka paraqitur ndonjë vlerësim të natyrës së terrenit që justifikon këtë nivel të pajisjes;
- Nuk ka trajtuar fare përputhjen me LPP dhe Rregulloren 002/2024, duke anashkaluar çështjen e ligjshmërisë së kërkesës.

4. • Gërmimet e përshkruara në paramasë janë të zakonshme për projekte komunale rrugore, të realizueshme me ekskavatorë të klasave 20–40 ton, që janë praktikë e zakonshme në industrinë e ndërtimit në Kosovë;

- Ekskavatorët mbi 50 ton përfaqësojnë klasë të rëndë industriale, të papërligjur për projekt të këtij niveli dhe kompleksiteti teknik;
- Vendosja e këtij kriteri përjashton operatorët që posedojnë mjete të plota dhe funksionale për realizimin e kontratës, duke ngritur barrë të panevojshme dhe joproporcionale.

5. Vlerësim ligjor:

Kjo kërkesë është:

- Në kundërshtim me nenin 7 të LPP-së, sepse nuk është proporcionale dhe vendos kufizim pa bazë funksionale;
- Në kundërshtim me nenin 59.3 të LPP-së, sepse nuk mbështetet në nevojë reale ose dokumentacion zbatimi;
- Në kundërshtim me nenin 19.2 të Rregullores 002/2024, i cili kërkon:

“Kriteret teknike të kenë lidhje të drejtpërdrejtë me përmbajtjen e kontratës dhe të justifikohen përmes analizës teknike.”

6. Vendime të OSHP-së të aplikueshme:

Vendimet:

- OSHP nr. 2023/0122
- OSHP nr. 2022/0579 kanë konstatuar se:

“Kërkesat për pajisje specifike të klasës së rëndë, të cilat nuk përputhen me natyrën e punimeve dhe nuk mbështeten në dokumentacionin teknik, janë diskriminuese dhe joproporcionale.”

7. Kërkesë për rishqyrtim:

Kërkojmë që Autoriteti Kontraktues:

- Të largojë kërkesën për ekskavator me peshë mbi 50 ton, për arsyet:

o Nuk është e justifikuar teknikisht në raport me natyrën e punimeve dhe dokumentet e kontratës;

o Përgjigja e dhënë është e paqartë ose nuk ekziston;

o Kjo kërkesë përbën kriter të tepruar dhe diskriminues, në kundërshtim me LPP-në dhe Rregulloren 002/2024.

Në Aneksin 8, pika 10, AK kërkon:

“2 copë ekskavatorë për gjërmim me peshë minimale 65 ton.”

2. Pyetjet e parashtruara në kërkesën për sqarim nga OE:

1. Cilat janë pozicionet specifike në paramasë që kërkojnë përdorimin e ekskavatorëve me peshë mbi 65 ton dhe përse kjo nuk mund të përmbushet me pajisje të zakonshme për gjërmime 20–40 ton që përdoren gjerësisht për këto qëllime?

2. Cili është justifikimi teknik për kërkesën për 2 copë të këtij ekskavatori me kapacitet ekstrem, duke marrë parasysh vëllimin e punimeve, natyrën e terrenit dhe afatet e zbatimit të kontratës?

3. A është bërë ndonjë vlerësim për ngarkesën operative që demonstroi se dy pajisje të kësaj peshe janë të domosdoshme dhe jo alternativa teknike me përdorim të njëpasnjëshëm të pajisjeve ekzistuese të klasës më të ulët?

4. A do të pranoheshin pajisje të krahasueshme në kapacitet (p.sh. 2 ekskavatorë 40 ton secili)?

5. A është kjo kërkesë vendosur në përputhje me nenin 7 të LPP-së dhe nenin 19.2 të Rregullores 001/2022 të ndryshuar me 002/2024, që kërkojnë lidhje të drejtëpërdrejtë ndërmjet kriterëve teknike dhe natyrës së kontratës?

3. Përgjigja e Autoritetit Kontraktues:

- AK nuk ka dhënë përgjigje konkrete për secilën pyetje;

- Nuk është identifikuar asnjë pozicion specifik në paramasë, si p.sh. 3.01 apo 3.02, që të kërkojë pajisje të klasës 65 ton;

- Nuk është ofruar asnjë analizë e natyrës së terrenit (p.sh. shkëmb, kompaktësi, thellësi) që ta justifikojë përdorimin e ekskavatorëve të kësaj peshe;

- Përgjigja është e përgjithësuar dhe nuk i përmbahet kërkesës për sqarim teknik, objektiv dhe proporcional.

4. • Pozitat 3.01 dhe 3.02 të paramasës kanë të bëjnë me gjërmim humusi dhe dheu të kategorive III, IV dhe V – që për nga natyra janë të përpunueshme me ekskavatorë 20–40 ton, të cilët përdoren gjerësisht në sektorin ndërtimor për projekte rrugore;

- Kërkesa për 2 ekskavatorë me peshë mbi 65 ton nuk përputhet me asnjë aspekt të projektit:

o As në volum,

o As në thellësi,

o As në urgjencën e afatit;

- Nuk është arsyetuar pse nuk do të ishte e mjaftueshme:

o përdorimi i një pajisjeje të kësaj mase në mënyrë të njëpasnjëshme, apo

o kombinimi i dy pajisjeve të klasës 30–40 ton.

5. Kundërshtim me ligjin dhe rregulloren përkatëse:

Kërkesa bie në kundërshtim me:

- Nenin 7 të LPP-së – për shkak se vendoset një kufizim që nuk është proporcional me objektin e kontratës;

- Nenin 67.6 të LPP-së, për arsye se nuk parashihen alternativa të vlefshme teknike;

- Nenin 19.2 të Rregullores 002/2024, i cili përcakton se:

“AK mund të kërkojë pajisje vetëm nëse është e nevojshme për përmbushjen e kontratës, dhe duhet të përshkruajë lidhjen ndërmjet kërkesës dhe përmbajtjes së kontratës.”

AK nuk ka përmbushur këtë detyrim, dhe ka vendosur një kërkesë që:

- Nuk është e qartë në funksion,

- Nuk është e lidhur me pozita të dokumentuara,

- Dhe nuk është e mbështetur në ndonjë analizë zyrtare.

6. Vendime të OSHP-së me precedent të ngjashëm:

Vendimet:

- OSHP nr. 2023/0131

- OSHP nr. 2022/0467 kanë theksuar se:

“Përcaktimi i pajisjeve të klasës së rëndë, pa analizë të objekteve konkrete, konsiderohet kriter i panevojshëm dhe përjashtues.”

7. Kërkesë për rishqyrtim:

Kërkojmë që Autoriteti Kontraktues:

- Të largojë kërkesën për “2 copë ekskavatorë me peshë minimale 65 ton”, për arsyet:

o Nuk është e justifikuar me pozicione konkrete në paramasë;

o Nuk përputhet me natyrën e projektit;

Kërkesa për 4 copë buldozerë – Kriter i pajustificuar teknikisht dhe kufizues për konkurrencën 1. Përmbajtja e kërkesës:

Në dokumentacionin e tenderit, Aneksi 8 – Pika 11, AK ka paraparë që OE të ofrojë: “4 copë buldozerë.”

2. Pyetjet e parashtruara nga OE në kërkesën për sqarim:

1. Cilat pozicione konkrete në paramasë justifikojnë kërkesën për angazhimin e 4 copë buldozerë njëkohësisht gjatë zbatimit të kësaj kontrate?

2. A është bërë një vlerësim i volumit të punës dhe dinamikës së zbatimit që demonstroi nevojën për më shumë se 1–2 buldozerë, që përfshihen zakonisht në kontrata të kësaj natyre dhe vlerë buxhetore?

3. A është numri 4 një kërkesë teknike e domosdoshme për tu përdorur në të njëjtën kohë, apo është vendosur si kriter shtesë që kufizon operatorët pa vlerësim të kapacitetit real të nevojshëm për projektin?

3. Përgjigja e dhënë nga AK:

- AK nuk ka ofruar përgjigje të drejtpërdrejtë për asnjërën nga pyetjet e parashtruara;
- Në vend të një arsytimi teknik mbi vëllimin e punimeve dhe nevojën operative për 4 buldozerë, ka dhënë një sqarim të përgjithshëm, duke theksuar “nevojën për cilësi dhe zbatim të suksesshëm të kontratës” – pa ndonjë lidhje të qartë me këtë pajisje;
- Nuk është përmendur asnjë pozicion konkret nga paramasa që kërkon angazhim paralel të 4 buldozerëve.

4. • Pozitat që lidhen me përdorimin e buldozerëve janë të zakonshme për projekte të kësaj natyre dhe përfshijnë:

- o Rrafshim terreni,
- o Hapje trase,
- o Nivelizim bazash rrugore,
- o Shtyerje mbushjesh inerte.

Këto punime zakonisht realizohen me 1–2 buldozerë, të cilët mund të operojnë në sekuencë ose paralel, në varësi të dinamikës së planifikuar.

- Kërkesa për 4 buldozerë nuk mbështetet:
 - o Në analizë të vëllimit të punimeve,
 - o As në kohëzgjatjen e kontratës,
 - o Dhe as në afatet e ndërlidhura me mobilizimin teknik.

5. Vlerësim ligjor:

- Vendosja e kësaj kërkesë nuk është në përputhje me nenin 7 të LPP-së, që kërkon që kriteret të jenë të:

- o Proporcionuara,

- o Jo diskriminuese,

- o Të lidhura ngushtë me përmbajtjen e kontratës.

- Neni 59.3 dhe 67.6 i LPP-së kërkon që kërkesat për pajisje të jenë objektivist të nevojshme dhe të justifikohen me analizë funksionale;

- Neni 19.2 i Rregullores 002/2024 përcakton qartë:

“Çdo kërkesë teknike duhet të jetë e lidhur drejt me objektin e kontratës dhe të jetë e justifikuar teknikisht.”

Në këtë rast, AK ka dështuar të bëjë këtë lidhje.

6. Vendime të OSHP-së për raste të ngjashme:

Vendimet si:

- OSHP nr. 2023/0143

- OSHP nr. 2022/0485 theksojnë:

“Kriteret që vendosen pa bazë në analizën e përmbajtjes teknike të kontratës dhe që tejkalojnë nevojat reale të projektit janë joproporcionale dhe kufizuese.”

7. Kërkesë për rishqyrtim:

Kërkojmë që Autoriteti Kontraktues:

- Të largojë ose rishikojë kërkesën për “4 copë buldozerë”, për shkak se:

- o Nuk është mbështetur në analizë funksionale të nevojës;

- o Nuk përputhet me natyrën dhe përmasat e punimeve;

- o Nuk është trajtuar me përgjigje teknike të veçantë në kërkesën për sqarim;

- o Shkel parimet e LPP-së dhe rregulloren 002/2024.

Në Aneksin 8 – Pika 8, AK kërkon:

“Cilindër vibruës (makinë ngjeshëse) me peshë minimale 26 ton.”

2. Pyetjet e parashtruara nga OE në kërkesën për sqarim (të cituara):

1. Cila është arsyeja teknike specifike që e justifikon kërkesën për një cilindër me peshë mbi 26 ton për punime që përfshijnë ngjeshje të shtresave të zakonshme të rrës, tamponit dhe materialit të mbushjes, të cilat zakonisht trajtohen me pajisje vibrimi 13–20 ton?

2. A është bërë ndonjë analizë laboratorike apo vlerësim i ngjeshshmërisë së tokës që imponon përdorimin e pajisjeve të kësaj klase për të arritur parametrat e specifikuar të moduleve të ngjeshjes?

3. A mund të konsiderohet pajisje alternative me performancë të barasvlershme (cilindër 13–20 ton) e vlefshme në rast se në praktikë të zakonshme arrin vlerat e kërkuara për shtresat e mbushjes sipas projektit?

4. A është kjo kërkesë vendosur në përputhje me nenin 7 dhe 59 të LPP-së dhe nenin 19.2 të Rregullores Nr. 001/2022 të ndryshuar me 002/2024 për proporcionalitet dhe lidhje të drejtpërdrejtë me objektin e kontratës?

3. Përgjigja e dhënë nga AK:

- AK nuk ka dhënë përgjigje specifike për asnjërën nga pyetjet e mësipërme;
- Nuk është përmendur asnjë pozicion konkret nga paramasa (si 3.06–3.08) që kërkon nivel ngjeshjeje që mund të arrihet vetëm me cilindër 26 ton;
- Nuk është përmendur asnjë analizë laboratorike ose vlerësim të ngjeshshmërisë së terrenit;
- Nuk është trajtuar mundësia për pajisje alternative të testuara praktikisht dhe të përdorura zakonisht (13–20 ton).

4. Vlerësim teknik:

- Pozitat për ngjeshje (3.06–3.08) përfshijnë:
 - o Shtresa të mbushjes, rrës, tamponit;
 - o Trashësi dhe karakteristika standarde për ndërtim rrugor lokal;
- Këto shtresa në praktikë ndërtohen dhe ngjeshen me cilindër 13–20 ton, të pajisura me vibrosistem me frekuencë të rregullueshme dhe presion të mjaftueshëm për arritjen e moduleve të kërkuara ($E_{v2}/E_{v1} \geq 2.2–2.5$).

5. Vlerësim ligjor:

Kjo kërkesë është në kundërshtim me:

- Nenin 7 të LPP-së, pasi është:
 - o joproporcionale për një kontratë të kësaj natyre,
 - o kufizuese ndaj operatorëve që përdorin pajisje të përdorshme në praktikën vendore dhe ndërkombëtare;
- Nenin 67.6 të LPP-së, sepse:

o Nuk jep alternativë (p.sh. certifikatë për arritje të ngjeshjes në test laboratorik, pa specifikuar markën e cilindrit);

• Nenin 19.2 të Rregullores 002/2024, që kërkon:

“Kërkesat teknike të jenë të lidhura drejt me përmbajtjen e kontratës dhe të justifikohen teknikisht.”

Në këtë rast, AK ka dështuar t’i përmbushë këto standarde.

6. Precedentë të ngjashëm nga OSHP:

Vendime si:

• OSHP nr. 2023/0146

• OSHP nr. 2022/0480 kanë konstatuar se:

“Vendosja e kërkesave për pajisje të dimensioneve ekstreme, pa lidhje direkte me objektin dhe pa

analizë të përmbajtjes së kontratës, është praktikë e papranueshme dhe diskriminuese.”

7. Kërkesë për rishqyrtim:

Kërkojmë që Autoriteti Kontraktues:

• Të heqë kërkesën për cilindër vibrues me peshë minimale 26 ton, për arsyet:

o Nuk ka lidhje funksionale me specifikimet e projektit;

o Është vendosur pa analizë të dokumentuar të nevojës teknike;

o Nuk është trajtuar drejt kërkesa për sqarim;

o Përbën kriter kufizues dhe përjashtues për pjesëmarrës të aftë për të realizuar punimet në mënyrë të barabartë dhe profesionale.

Kërkesa për 4 copë ngarkues 3–4 m³ –

1. Përmbajtja e kërkesës në dokumentet e tenderit:

Në Aneksin 8, AK kërkon:

“4 copë ngarkues (kapacitet 3–4 m³).”

2. Pyetjet zyrtare të parashtruara në kërkesën për sqarim (të cituara):

1. Cilat janë pozicionet specifike në paramasë që justifikojnë përdorimin e njëkohshëm të 4 copë ngarkuesish 3–4 m³ për të përmbushur kërkesat e projektit?

2. A është bërë ndonjë analizë e fluksit të materialit që lëvizet përmes këtyre pajisjeve dhe që tregon nevojën për të paktën 4 njësi të dedikuara për këtë projekt konkret?

3. A mund të përmbushet funksioni i këtyre mjeteve me numër më të reduktuar, në kombinim me ekskavatorët e shumtë që janë gjithashtu të kërkuar në Aneksin 8, dhe që në praktikë mbulojnë shumë prej funksioneve të përbashkëta të gërmimit dhe ngarkimit?

4. A është vendosur kjo kërkesë në përputhje me nenin 7 dhe nenin 59 të LPP-së dhe nenin 19.2 të Rregullores 002/2024, që përcaktojnë se kriteret teknike duhet të jenë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe të jenë të arsyetuara proporcionalisht?

3. Përgjigja e dhënë nga AK:

- AK nuk ka dhënë përgjigje konkrete dhe teknike për asnjërën nga pyetjet;

- Nuk ka treguar:

- o Asnjë pozicion të paramasës që kërkon angazhim paralel të 4 ngarkuesve;

- o Asnjë vlerësim të volumit të materialeve që do të përpunohen dhe që do të arsyetonin këtë flotë;

- o As ndonjë arsyetim se pse përdorimi i ekskavatorëve nuk mund të përmbushë funksione të përbashkëta të gërmim-ngarkimit.

4. • Në projektin në fjalë, materialet që do të përpunohen dhe lëvizten janë tipike për ndërtim rrugor lokal: zhavor, rërë, mbushje;

- Këto sasi përpunohen me pajisje standarde dhe në mënyrë të ndarë sipas fazave të ndërtimit, jo me nevojë për 4 ngarkues njëkohësisht;

- Në Aneksin 8 janë të kërkuar një numër shumë i madh i ekskavatorëve dhe bagerave (përfshirë edhe ato mbi 50 dhe 65 ton), të cilët në praktikë mbulojnë shumë prej funksioneve që zakonisht mbulohen nga ngarkuesit.

5. Vlerësimi ligjor:

Kjo kërkesë:

- Nuk përputhet me nenin 7 të LPP-së, sepse nuk është proporcionale dhe cenon konkurrencën;

- Shkel nenin 59.3 dhe 67.6 të LPP-së, pasi:

- o Nuk jep mundësi zëvendësimi funksional (p.sh. 2 ngarkues + 2 ekskavatorë në bashkëveprim);

- o Nuk justifikohet nga analiza teknike funksionale;

- Nuk përputhet me nenin 19.2 të Rregullores 002/2024, e cila kërkon që kriteret teknike:

“Të jenë të lidhura drejt me përmbajtjen e kontratës dhe të jenë të justifikuara në mënyrë të verifikueshme.”

6. Vendime të OSHP-së të aplikueshme:

- OSHP nr. 2023/0117

- OSHP nr. 2022/0451

Në të dy vendimet, paneli ka konstatuar se:

“Vendosja e kërkesave për numër të lartë të pajisjeve pa bazë në analizën e volumit dhe dinamikës së punimeve është joproporcionale dhe kufizuese.”

7. Kërkesë për rishqyrtim:

Kërkojmë që Autoriteti Kontraktues:

- Të rishikojë ose largojë kërkesën për 4 copë ngarkues 3–4 m³, për shkak se:
 - o Nuk mbështetet në analizë të fluksit të materialeve;
 - o Nuk është e justifikuar me pozita specifike në paramasë;
 - o Mund të mbulohet funksionalisht me më pak njësi ose përmes pajisjeve ekzistuese të përfshira në Aneksin 8 (eksavatorë dhe bagerë);
 - o Nuk përputhet me LPP dhe Rregulloren 002/2024.

Në Aneksin 8 – Pika 12, AK kërkon:

“Ngarkues me zinxhir me peshë minimale 22 ton.”

2. Pyetjet e parashtruara në kërkesën për sqarim (të cituara):

1. Cili është funksioni konkret në këtë projekt që kërkon ngarkues me zinxhir 22 ton, dhe në cilat pozita të paramasës është i parashikuar ky përdorim?
2. A është identifikuar ndonjë vështirësi teknike ose tipologji e terrenit që kërkon specifikisht zinxhir (krahastuar me pajisje me goma), apo kjo është kërkesë standarde e përgjithshme pa vlerësim teknik të aplikueshmërisë në këtë projekt?
3. A mund të përmbushet kjo kërkesë përmes pajisjeve të tjera të krahasueshme në kapacitet, si ngarkues të mëdhenj me goma ose ekskavatorë që tashmë janë të përfshirë në listën e pajisjeve të kërkuara në Aneksin 8?
4. A është kërkesa për ngarkues me zinxhir 22 ton vendosur në përputhje me nenin 7 dhe 59 të LPP-së dhe nenin 19.2 të Rregullores Nr. 001/2022 të ndryshuar me Nr. 002/2024?

3. Përgjigja e dhënë nga AK:

- AK nuk ka dhënë ndonjë përgjigje të drejtpërdrejtë për secilën nga pyetjet e mësipërme;
- Nuk është treguar asnjë pozicion në paramasë ku përdorimi i ngarkuesit me zinxhir 22 ton është i domosdoshëm;
- Nuk është paraqitur asnjë analizë teknike që shpjegon nëse terreni kërkon specifikisht zinxhir për arsye stabiliteti apo ngarkese;

- Nuk është marrë në konsideratë që lista e pajisjeve në Aneksin 8 tashmë përmban ekskavatorë dhe ngarkues të tjerë me goma, që në praktikë mbulojnë të njëjtin funksion.

4. • Në përmbajtjen e kontratës dhe në paramasë nuk parashihen punime në kushte të veçanta terreni (p.sh. baltë, pjerrësi ekstreme ose zonë me akses të kufizuar) që të kërkojnë ngarkues me zinxhir në vend të atyre me goma;

- Funksionet e këtij mjeti (ngarkim, bartje, lëvizje masash dheu ose inerte) mbulohen tashmë nga ekskavatorët e shumtë dhe ngarkuesit me goma që janë kërkuar në Aneksin 8;

- Kjo krijon mbivendosje të panevojshme të funksioneve të mjeteve, dhe rrit kufizimin teknik pa arsytim funksional.

5. Vlerësimi ligjor:

Kërkesa është në kundërshtim me:

- Nenin 7 të LPP-së, sepse:

- o Vendos kufizim të pajustificuar teknikisht;

- o Nuk garanton proporcionalitet me përmbajtjen e kontratës;

- Nenin 59.3 dhe 67.6 të LPP-së, sepse:

- o Nuk paraqet nevojë reale;

- o Nuk jep alternativë funksionale;

- Nenin 19.2 të Rregullores 002/2024, që thekson se:

“Kërkesat teknike duhet të jenë të lidhura drejt me përmbajtjen e kontratës dhe të justifikohen përmes dokumentacionit teknik.”

Në këtë rast, AK nuk ka paraqitur as dokumentim, as analizë, vetëm një përfshirje të mjetit në listën standarde pa mbështetje funksionale.

6. Vendime të OSHP-së me precedent të ngjashëm:

- OSHP nr. 2023/0115

- OSHP nr. 2022/0463

Të cilat konstatojnë se:

“Vendosja e pajisjeve të specializuara, pa argument teknik të lidhur me kontratën dhe duke anashkaluar mundësinë e përmbushjes me mjete të krahasueshme, përbën kufizim të pajustificuar.”

7. Kërkesë për rishqyrtim:

Kërkojmë që Autoriteti Kontraktues:

- Të largojë kërkesën për ngarkues me zinxhir 22 ton, për shkak se:
 - o Nuk mbështetet në dokumentacionin teknik ose paramasë;
 - o Nuk është shpjeguar në mënyrë funksionale;
 - o Përmban mbivendosje të pajisjeve që tashmë janë të përfshira në Aneksin 8;
 - o Shkel dispozitat e LPP-së dhe Rregullores 002/2024 për vendosjen e kriterëve proporcionale dhe të arsyetuara.

Në Aneksin 8 – Pika 13, Autoriteti Kontraktues ka vendosur si kriter teknik:

“Të ofrohet një ngarkues me kapacitet minimal 60 ton.”

2. Pyetjet e parashtruara në kërkesën për sqarim (të cituara):

1. Cilat janë pozicionet konkrete në paramasë që e justifikojnë përdorimin e një ngarkuesi me kapacitet 60 ton dhe përse nuk mund të përdoren alternativat standarde në praktikën ndërtimore komunale?
2. A është bërë ndonjë analizë teknike mbi dinamikën e punimeve që kërkon kapacitet kaq të lartë, duke marrë parasysh që pjesa më e madhe e materialit të transportueshëm është standard dhe i zakonshëm në projektet e ngjashme?
3. A është kjo kërkesë vendosur në përputhje me nenin 7 dhe 59 të Ligjit për Prokurimin Publik, si dhe nenin 19.2 të Rregullores Nr. 001/2022 të ndryshuar me 002/2024, që kërkojnë që kriteret teknike të lidhen drejtpërdrejt me objektin e kontratës dhe të jenë të arsyetuara në mënyrë proporcionale?

3. Përgjigja e dhënë nga AK:

- AK nuk ka dhënë përgjigje konkrete për ndonjë pozicion të paramasës që kërkon kapacitet 60 ton të ngarkuesit;
- Nuk është prezantuar ndonjë analizë teknike mbi fluksin e materialeve ose dinamikën që ta justifikojë këtë kapacitet;
- Përgjigjja është e përgjithësuar dhe e pambështetur teknikisht, duke mos dhënë sqarim nëse mjeti kërkohet për funksione specifike që nuk mund të realizohen me pajisje 20–30 ton.

4. • Materialet e përfshira në këtë kontratë janë:

- o zhavor, mbushje, rërë, tampon, – të gjitha të zakonshme në ndërtim rrugor;
- Ngarkuesit me kapacitet 20–30 ton janë standardi industrial për këto lloj punimesh, dhe përdoren gjerësisht në praktikën ndërtimore komunale në Kosovë dhe rajon;
- Kërkesa për pajisje me kapacitet ekstrem prej 60 ton është:

- o Jashtë praktikës,
- o E pa lidhur me ndonjë pozicion konkret të punimeve,
- o E paprovuar si domosdoshmëri teknike.

5. Vlerësimi ligjor:

Kjo kërkesë bie ndesh me:

- Nenin 7 të LPP-së, sepse vendos një kriter joproporcional, që kufizon pjesëmarrjen pa bazë teknike;
- Nenin 59.3 dhe 67.6 të LPP-së, sepse:
 - o Nuk përfshin vlerësim objektiv të nevojës;
 - o Nuk ofron forma alternative për përmbushjen e funksionit të mjetit;
- Nenin 19.2 të Rregullores 002/2024, i cili kërkon që çdo kërkesë teknike të:

“Jetë e lidhur drejt me përmbajtjen e kontratës dhe e justifikuar përmes dokumentacionit teknik përkatës.”

6. Vendime të OSHP-së me precedentë të ngjashëm:

- OSHP nr. 2022/0573,
- OSHP nr. 2023/0124 konstatojnë se:

“Përcaktimi i pajisjeve të kapaciteteve të larta, pa lidhje me kontratën dhe pa analizë të vëllimit real të punimeve, është i paarsyetuar dhe përbën kufizim të panevojshëm.”

7. Kërkesë për rishqyrtim:

Kërkojmë që Autoriteti Kontraktues:

- Të largojë kërkesën për ngarkues me kapacitet minimal 60 ton, për arsye se:
 - o Nuk është e mbështetur në përmbajtjen teknike të kontratës;
 - o Nuk është e justifikuar me analizë funksionale të nevojës;
 - o Kufizon OE pa shkak real teknik, duke shkelur nenin 7 dhe 67 të LPP-së dhe Rregulloren 002/2024.

Aneksin 8 – Pika 16, AK kërkon:

“1 copë dumper deri në 5 ton me matje digjitale.”

2. Pyetjet e parashtruara nga OE në kërkesën për sqarim (të cituara):

1. Cilat janë pozicionet konkrete të paramasës që kërkojnë përdorimin e një dumperi të klasës 5 ton, duke pasur parasysh që punimet për mbushje, zhvendosje të dheut dhe materialeve zakonisht realizohen përmes ngarkuesve, ekskavatorëve ose automjeteve më të mëdha për efikasitet?

2. Cili është funksioni i kërkuar i matjes digjitale në këtë pajisje dhe si ndërlidhet kjo me ndonjë specifikim teknik të punimeve ose ndonjë kriter kontrolli të sasisë në projekt?

3. A është vendosur kjo kërkesë për pajisje digjitale në përputhje me nenin 7 dhe 59 të LPP-së dhe me nenin 19.2 të Rregullores 002/2024, e cila kërkon që kriteret teknike të jenë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe të justifikohen proporcionalisht?

4. A pranohen alternativa të tjera për përmbushjen e funksionalitetit të transportit të lehtë të materialeve, nëse matja digjitale nuk paraqitet si kriter i domosdoshëm teknik në këtë projekt?

3. Përgjigja e AK dhe vlerësimi kritik:

- AK nuk ka dhënë përgjigje specifike për ndonjë pozicion të paramasës që kërkon përdorim ekskluziv të një dumperi 5 ton me matje digjitale;

- Nuk është sqaruar funksioni i matjes digjitale, as lidhja e saj me ndonjë specifikim në projekt apo metodë kontrolli të punimeve;

- Përgjigja është e përgjithësuar dhe nuk përmbush kërkesat ligjore për qartësi dhe proporcionalitet teknik.

4. • Transporti i materialeve të lirshme në këtë kontratë (zhavor, mbushje, rërë) realizohet zakonisht me mjete më të mëdha ose përmes ekskavatorëve dhe ngarkuesve, të cilët tashmë janë të kërkuar në Aneksin 8;

- Dumperët e klasës 5 ton janë mjete ndihmëse për punime të specializuara në kushte të veçanta (akses i ngushtë, terren i pjerrët) – kushte që nuk janë të identifikuara në këtë kontratë;

- Matja digjitale për dumper me kapacitet 5 ton nuk është standard teknik i kërkuar në asnjë pjesë të dokumentacionit teknik dhe nuk është e lidhur me sistem të kontrollit elektronik apo metodologji për masim sasisor.

5. Vlerësim ligjor: Kjo kërkesë:

- Shkel nenin 7 të LPP-së, sepse vendos një kufizim që nuk është i lidhur me përmbajtjen reale të kontratës;

- Shkel nenin 59.3 dhe 67.6 të LPP-së, pasi nuk:

- o Përcakton nevojë të qartë funksionale;

- o Ofron alternativa të krahasueshme për pajisje me të njëjtin funksion pa matje digjitale;

- Nuk përputhet me nenin 19.2 të Rregullores 002/2024, që thotë:

“Çdo kërkesë teknike duhet të jetë e justifikuar dhe e lidhur drejt me objektin e kontratës.”

6. Vendime të OSHP-së me precedentë të ngjashëm:

- OSHP nr. 2023/0172

- OSHP nr. 2022/0501 të cilat kanë konstatuar:

“Vendosja e teknologjive specifike (si matje digjitale) në mjete ndihmëse pa lidhje funksionale me përmbajtjen e kontratës është praktikë diskriminuese dhe e papranueshme.”

7. Kërkesë për rishqyrtim:

Kërkojmë që Autoriteti Kontraktues:

- Të largojë kërkesën për dumper deri në 5 ton me matje digjitale, për arsye se:

- o Nuk është e justifikuar teknikisht me ndonjë pozitë në paramasë;

- o Matja digjitale nuk është e paraparë në dokumentacionin teknik si kërkesë funksionale;

- o Shkel parimet e proporcionalitetit dhe barazisë të garantuara me LPP dhe Rregulloren 002/2024.

ë Aneksin 8 – Pika 17, kërkohet:

“1 copë makineri për grryerje dhe përpunim të asfaltit me peshë minimale 42 ton.”

2. Pyetjet zyrtare të parashtruara nga OE në kërkesën për sqarim (të cituara):

1. A është kërkesa për makineri me peshë 42 ton e domosdoshme për realizimin e pozicionit 2.01 të paramasës, dhe nëse po, a ka specifikime që tregojnë trashësi ose sipërfaqe të gërryer që kërkojnë pajisje të kësaj kategorie të rëndë?

2. A mund të realizohen këto punime përmes metodave alternative të përpunimit mekanik të asfaltit me makineri më fleksibile, që janë të zakonshme për ndërhyrje të këtij lloji?

3. A është vendosur kjo kërkesë në përputhje me nenin 7 dhe 59 të LPP-së dhe nenin 19.2 të Rregullores 001/2022 të ndryshuar me Nr. 002/2024?

3. Përgjigja e AK dhe vlerësimi kritik:

- AK nuk ka ofruar përgjigje të saktë për lidhjen midis kërkesës për makineri 42 ton dhe pozicionit 2.01 në paramasë;

- Pozicioni i vetëm që përfshin grryerje asfalti është 2.01, i cili përshkruan:

“Demolim i asfaltit ekzistues së bashku me skajoret dhe transporti në deponi”;

- Nuk ka sqaruar:

- o Trashësinë e asfaltit,

- o Sipërfaqen që do të përpunohet,

- o Arsyen pse pajisje më të vogla (15–25 ton) nuk mund ta realizojnë këtë detyrë.

4. • Në praktikën inxhinierike, grryerja e asfaltit me trashësi standarde deri në 10–15 cm për realizimin e ndërhyrjeve rrugore lokale realizohet me pajisje më të lehta, të cilat:

o Janë më fleksibile,

o Përdoren gjerësisht për punime të këtij lloji,

o Janë më të përballueshme për OE.

• Kërkesa për makineri 42 ton është klasifikuese si e rëndë industriale, zakonisht për rrugë nacionale apo asfalt strukturor të shumëfishtë – gjë që nuk aplikohet në këtë projekt.

5. Vlerësim ligjor:

Kërkesa bie ndesh me:

• Nenin 7 të LPP-së, sepse nuk është:

o Proporcionale me objektin,

o E justifikuar teknikisht,

o E bazuar në ndonjë dokument teknik shoqërues;

• Nenin 59.3 dhe 67.6 të LPP-së, pasi:

o Nuk parashtron zgjidhje alternative funksionale;

o Nuk përmend ndonjë analizë teknike që arsyeton këtë kërkesë;

• Nenin 19.2 të Rregullores 002/2024, që përcakton:

“AK mund të kërkojë pajisje vetëm kur ekziston lidhje e drejtëpërdrejtë me përmbajtjen e kontratës dhe kjo të jetë e justifikuar përmes dokumentacionit të tenderit.”

6. Vendime të OSHP-së me precedent të ngjashëm:

• OSHP nr. 2022/0532

• OSHP nr. 2023/0174 konstatojnë se:

“Vendosja e pajisjeve specifike për një pozicion të vetëm të kontratës, pa lidhje me vëllimin apo natyrën reale të punimeve, përbën kufizim të panevojshëm.”

7. Kërkesë për rishqyrtim:

Kërkojmë që Autoriteti Kontraktues:

• Të heqë ose rishikojë kërkesën për makineri për grryerje asfaltit me peshë minimale 42 ton, për arsyet:

o Kjo pajisje nuk është e domosdoshme për pozicionin 2.01 të paramasës;

- o Puna mund të realizohet me pajisje alternative të përshtatshme dhe të testuara në praktikë;
- o Nuk është e arsyetuar teknikisht dhe vendoset në kundërshtim me nenet 7, 59 dhe 67 të LPP-së si dhe me Rregulloren 002/2024. Aneksin 8 – Pika 18, kërkohet:

5 copë kamion kiper për transport të asfaltit me kapacitet minimal 20 ton.”

2. Pyetjet zyrtare të parashtruara në kërkesën për sqarim (të cituara):

1. A është pesha e kërkuar 20 ton në këtë rast e lidhur me kapacitetin e ngarkesës së lejuar, për transport të asfaltit të gatshëm apo me peshën bruto të automjetit, që përfshin peshën vetjake + ngarkesën maksimale?
2. A ekziston ndonjë specifikim teknik në dokumentacionin tuaj që e bën të qartë mënyrën e interpretimit të kësaj peshe për pajisjet e transportit të asfaltit?
3. A do të pranohej një kamion kiper me kapacitet real transporti 14–16 ton, nëse ai arrin të përmbushë në mënyrë efektive furnizimin dhe shkarkimin e asfaltit sipas ritmit të vendosur në planin e punës?

3. Përgjigja e AK dhe vlerësimi teknik:

- AK nuk ka dhënë asnjë përgjigje të qartë që specifikon nëse pesha 20 ton i referohet peshës bruto të automjetit apo kapacitetit real të ngarkesës së lejuar;

- Nuk është sqaruar nëse:

o Vlera 20 ton është masa teknike totale e mjetit (GVW);

o Apo nëse kërkohet ngarkesë neto e lejuar për asfaltin (payload);

- Nuk është përmendur asnjë standard referues për interpretimin e kësaj kërkesë, si p.sh. fletë-teknike, Udhëzues Teknik për Pajisje apo bazë logjistike për ritmin e furnizimit me asfalt.

4. • Kamionët me kapacitet transporti real 14–16 ton asfalt janë standard industrial për projekte të ndërtimit të rrugëve të mesme/lokale;

- Kërkesa për njësi me kapacitet 20 ton:

o Nuk është e domosdoshme, pasi nuk ka përmendur nevojë për ngarkesë voluminoze në interval të shkurtër;

o Nuk është e arsyetuar me grafikun e asfaltimit, distancën nga baza, apo nevojën për kapacitet të lartë të njëhershëm;

- Në mungesë të specifikimeve të qarta, kjo kërkesë paraqet paqartësi teknike dhe potencialisht diskriminon operatorë që përdorin pajisje plotësisht funksionale por me kapacitet të zakonshëm transporti.

5. Vlerësim ligjor:

- Kjo kërkesë bie ndesh me:

o Nenin 7 të LPP-së, për shkak se është joproporcionale dhe e paqartë për OE;

o Nenin 59.3 dhe 67.6 të LPP-së, pasi nuk:

? Përcakton qartë kuptimin e “kapacitetit”;

? Ofron mundësi teknike alternative për përmbushje të funksionit;

• Shkel Nenin 19.2 të Rregullores 002/2024, i cili kërkon që çdo kërkesë:

“Të jetë e qartë, e lidhur drejt me përmbajtjen e kontratës dhe e justifikuar përmes analizës teknike.”

6. Vendime të OSHP-së të aplikueshme:

• OSHP nr. 2022/0562

• OSHP nr. 2023/0169

ku është konstatuar se:

“Kriteret e vendosura me përshkrime të paqarta teknike ose që nuk saktësojnë parametrat e kuptueshëm të përmbushjes përbëjnë kufizim të panevojshëm dhe janë në kundërshtim me nenin 59 të LPP-së.”

7. Kërkesë për rishqyrtim – mungesë përgjigjeje dhe kërkesë për largim të pikës:

Duke qenë se Autoriteti Kontraktues nuk ka dhënë asnjë përgjigje specifike dhe teknike ndaj pyetjeve të qarta të parashtruara në kërkesën për sqarim, dhe nuk ka sqaruar nëse kapaciteti 20 ton i referohet peshës bruto apo ngarkesës neto të lejuar, atëherë:

Kërkojmë që kjo pikë të largohet nga Aneksi 8, si kërkesë e paqartë dhe e paarsyetuar.

Arsyetimi:

• AK ka detyrim ligjor, sipas nenit 49.2 të LPP-së, të kthejë përgjigje të qarta, të kuptueshme dhe të bazuara teknikisht për secilën kërkesë për sqarim;

• Moskthimi i përgjigjes për këtë pikë përbën mosrespektim të këtij obligimi ligjor dhe shkelje të drejtës së OE për informim të barabartë dhe korrekt në përgatitje të ofertës;

• Kjo përbën gjithashtu shkelje të nenit 7 dhe 59 të LPP-së, si dhe nenit 19.2 të Rregullores 002/2024, që kërkojnë:

o Lidhje funksionale të kërkesave me objektin e kontratës;

o Proporcionalitet teknik;

o Qartësi të kriterëve që ndikojnë në përmbushjen e kontratës.

Aneksin 8 – Pika 23 kërkohet:

“Ngjeshëse hidraulike e montuar në ekskavator, me peshë 900–1000 kg.”

2. Pyetjet e parashtruara nga OE në kërkesën për sqarim (të cituara):

1. A kërkohet domosdoshmërisht që ngjeshësja të jetë hidraulike dhe e montuar në bager, apo pranohet edhe ngjeshëse pneumatik apo e pavarur në strukturë të dedikuar për përdorim sipërfaqësor me forcë të ngjashme goditëse?

2. A ekziston ndonjë pozicion në paramasë që përcakton qartë nevojën për ngjeshje të thellësisë së shkëmbit apo prishje të strukturave të ngurta që kërkon domosdoshmërisht pajisje të montuar në bager?

3. A është e pranueshme përmbushja e kësaj kërkesë me mjete të krahasueshme me fuqi goditëse të ngjashme (900–1000 kg), pavarësisht nëse janë montuar në bager apo janë të pavarura?

3. Përgjigja e AK dhe vlerësimi kritik:

- AK nuk ka dhënë përgjigje specifike dhe nuk ka bërë dallim teknik ndërmjet pajisjes së kërkuar dhe alternativave të vlefshme;

- Nuk është identifikuar asnjë pozicion në paramasë që kërkon përdorimin e pajisjeve për prishje të strukturave të ngurta apo ngjeshje të thellë të shkëmbit, që do të kërkonte ngjeshëse të montuar në bager;

- Nuk është bërë dallimi ndërmjet pajisjeve të montuara dhe atyre të pavarura, përderisa forca goditëse dhe kapaciteti teknik mund të jetë i njëjtë.

4. • Ngjeshësja 900–1000 kg është pajisje që zakonisht përdoret për:

- o Prishje të strukturave të betonit të armatosur,

- o Saldim të sipërfaqeve të shkëmbinjve të vegjël,

- o Ose hapje të rrugëve në tokë të fortë – elemente që nuk janë të reflektuara në përmbajtjen e kësaj kontrate;

- Për punime përgatitore, përpunim mbushjesh dhe pastrim të skajeve, pajisjet e tjera të krahasueshme të pavarura ose të kombinuara janë të barasvlershme funksionalisht;

- Imponimi i montimit në ekskavator është kufizues teknik dhe nuk ka bazë në projektin aktual.

5. Vlerësimi ligjor:

Kjo kërkesë shkel:

- Nenin 7 të LPP-së, sepse vendos kufizim teknik që nuk lidhet drejt me kontratën;

- Nenin 59.3 dhe 67.6 të LPP-së, pasi nuk:

- o Justifikon nevojën për pajisje specifike të montuar,

- o Ofron alternativë të barasvlershme;

- Nenin 19.2 të Rregullores 002/2024, që kërkon:

“Çdo kërkesë teknike të jetë e lidhur drejt me përmbajtjen e kontratës dhe e justifikuar përmes dokumentacionit teknik.”

6. Vendime të OSHP-së me precedent të ngjashëm:

- OSHP nr. 2023/0134,
- OSHP nr. 2022/0582, konstatojnë se:

“Vendosja e kritereve teknike që përjashtojnë pajisje të barasvlershme për nga kapaciteti dhe performanca, pa justifikim teknik të lidhur me kontratën, është joproporcionale dhe e papranueshme.”

7. Kërkesë për rishqyrtim:

Kërkojmë që Autoriteti Kontraktues:

- Të largojë kërkesën për ngjeshëse 900–1000 kg të montuar në bager, duke:
- Të veprojë në përputhje me LPP dhe Rregulloren 002/2024, duke shmangur kufizime që nuk janë të nevojshme për realizimin efektiv të kontratës.

Makineri për saldim gypash Ø900–Ø1200 mm – Pajisje e paarsyetuar dhe jo e lidhur me përmbajtjen e kontratës 1. Përmbajtja e kërkesës:

Në Aneksin 8 – Pika 24, kërkohet:

“Makinë për saldim të gypave PVC-HDPE me diametër Ø900–Ø1200 mm.”

2. Pyetjet e parashtruara nga OE në kërkesën për sqarim (të cituara):

1. Cilat janë pozicionet specifike në paramasë që kërkojnë përdorimin e makinerisë për saldim të gypave Ø900–Ø1200mm dhe a mund të identifikohet saktësisht materiali dhe lloji i lidhjes së kërkuar për gypat përkatës?

2. A ka ndonjë kërkesë për vendosjen e rrjeteve të ujit të madhësive të tilla me saldim të domosdoshëm ose mund të përdoren alternativa si lidhje me elemente gome, mekanike ose gypa të paravendosur të formatuar?

3. A është vendosur kjo kërkesë në përputhje me nenin 7 dhe 59 të LPP-së dhe nenin 19.2 të Rregullores Nr. 001/2022 të ndryshuar me 002/2024, që kërkon që kriteret të lidhen ngushtë me objektin dhe përmbajtjen konkrete të kontratës?

3. Përgjigja e dhënë nga AK:

- AK nuk ka dhënë përgjigje specifike që identifikon ndonjë pozitë në paramasë që përfshin punime me gypa Ø900–Ø1200 mm;

- Nuk është sqaruar nëse punimet në kontratë përfshijnë tubacione presioni të mëdha plastike, që kërkojnë saldim me makinë të specializuar;

- Nuk është trajtuar mundësia e përdorimit të metodave alternative të lidhjes, si:

- o lidhje me unazë gome (push-fit),

- o lidhje mekanike me flange ose manikë,

- o apo gypa të paravendosur me lidhje të integruar nga prodhuesi.

4. • Në paramasën e kontratës nuk figurojnë pozicione që përfshijnë vendosjen e gypave me diametër Ø900–Ø1200 mm të llojit HDPE ose PVC;

- Nuk përmendet saldim i tubacioneve me diametër të madh, as rrjet presioni apo ujësjellës industrial;

- Kjo pajisje është specializuar për infrastrukturë të veçantë, si:

- o rrjete rajonale,

- o kolektorë presioni të mëdhenj industrial,

- o ujësjellës të qyteteve – jo për projektet lokale të rrugëve.

5. Vlerësimi ligjor:

Kërkesa:

- Nuk përmbush nenin 7 të LPP-së, pasi vendoset një kriter teknik i palidhur me objektin e kontratës dhe që kufizon pjesëmarrjen;

- Shkel nenin 59.3 dhe 67.6 të LPP-së, sepse:

- o Nuk justifikohet nga dokumentacioni teknik,

- o Nuk ofron alternativë për përmbushje të funksionit (p.sh. lidhje mekanike);

- Shkel nenin 19.2 të Rregullores 002/2024, i cili përcakton se:

“AK mund të kërkojë pajisje të caktuara vetëm nëse ato janë të lidhura drejt me përmbajtjen e kontratës dhe të justifikueshme teknikisht.”

6. Vendime të OSHP-së me precedent të ngjashëm:

- OSHP nr. 2022/0603

- OSHP nr. 2023/0137 ku paneli ka konstatuar:

“Vendosja e kritereve për pajisje që nuk janë të reflektuara në dokumentet e kontratës ose paramasë, dhe që nuk janë domosdoshmëri teknike, përbën kufizim dhe është në kundërshtim me LPP.”

7. Kërkesë për rishqyrtim:

Kërkojmë që Autoriteti Kontraktues:

- Të largojë kërkesën për makinë saldimi për gypa Ø900–Ø1200 mm, për arsye se:
 - o Kjo pajisje nuk ka mbështetje në dokumentacionin teknik;
 - o Nuk përputhet me natyrën e kontratës dhe pozicionet në paramasë;
 - o Nuk është trajtuar në përgjigjen e sqarimeve;
 - o Shkel dispozitat e LPP-së dhe Rregullores 002/2024. neksin 8 – Pika 26, kërkohet:

“Dron I pajisur me sensore Lidar dhe me mundësi operimi RTK DHE PPK.Droni te jete I regjistruar ne Autoritetin e Avicanonit Civil ”

2. Pyetjet e parashtruara nga OE në kërkesën për sqarim (të cituara):

1. Cila është lidhja konkrete ndërmjet kërkesës për dron dhe ndonjë pozicioni të caktuar në paramasë ose specifikim teknik që kërkon përpunim të të dhënave vizuale ajrore?
2. A është funksioni i dronit vetëm dokumentues për fotografim dhe video të progresit të punimeve apo është paraparë si mjet mbikëqyrës teknik për gjeodezi, topografi apo për masë pune?
3. A pranohen alternativa të tjera si shërbime me kontratë për xhirime ajrore, nëse nuk kërkohet përdorim teknik për mbikëqyrje të detajuar?
4. A është kjo kërkesë në përputhje me nenin 7 dhe 59 të LPP-së dhe nenin 19.2 të Rregullores 002/2024 që kërkon që pajisjet të jenë në përputhje me objektin dhe nevojat reale të kontratës?

3. Përgjigja e dhënë nga AK:

- AK nuk ka ofruar përgjigje të veçantë për këtë pikë, dhe nuk ka sqaruar:
 - o Nëse droni është i domosdoshëm për punime konkrete në paramasë;
 - o Apo nëse është për qëllime dokumentimi vizual të progresit të punimeve;
- Nuk është përmendur ndonjë metodologji e monitorimit teknik apo topografik që e kërkon domosdoshmërisht këtë pajisje.
- 4. • Në kontratë nuk ekziston ndonjë pozicion në paramasë që përfshin mbikëqyrje të punimeve përmes dronit;
- Nuk ka specifikime teknike për:
 - o Monitorim gjeodetik,
 - o Mbledhje të dhënash për volum ose sasi përmes fotogrametrisë,

o Ose ndonjë kërkesë për skanime ajrore LIDAR/RTK që kërkojnë pajisje të specializuara;

- Në rast se kërkesa është vetëm për fotografi/video progresi, kjo mund të sigurohet përmes kontratës me një ofrues shërbimi – pa imponuar pajisje të dedikuara në pronësi të OE.

5. • Vendosja e kësaj kërkesë është në kundërshtim me nenin 7 të LPP-së, pasi:

o Nuk është proporcionale me nevojën reale;

o Vendos kufizim të pajustificuar për pjesëmarrësit;

- Shkel:

o Nenin 59.3 dhe 67.6 të LPP-së, sepse nuk ofron asnjë mundësi alternative teknike për përmbushje të funksionit;

o Nenin 19.2 të Rregullores 002/2024, e cila kërkon:

“Kriteret për pajisje të jenë të lidhura drejt me përmbajtjen e kontratës dhe të justifikohen me analizë teknike ose dokumentacion të projektit.”

6. Vendime të OSHP-së me precedent të ngjashëm:

- OSHP nr. 2023/0147

- OSHP nr. 2022/0428 nënvizojnë se:

“Kërkesat për pajisje të pa reflektuara në paramasë ose që nuk janë pjesë e metodologjisë së punimeve përbëjnë kufizim teknik të pajustificuar dhe cenojnë barazinë në konkurrencë.”

7. Kërkesë për rishqyrtim:

Kërkojmë që Autoriteti Kontraktues:

- Të largojë kërkesën për pajisje “dron për monitorim ajror” nga Aneksi 8, për arsye se:

o Nuk është e përfshirë në asnjë pozicion të paramasës;

o Nuk është e lidhur me metodologji specifike të kontrollit, gjeodezisë apo matjes së progresit;

o Mund të zëvendësohet me shërbim të kontraktuar nëse kërkohet për qëllime dokumentimi;

o Shkel dispozitat e LPP-së dhe Rregullores 002/2024.

Pajisje gjeodezike Stacion Total me system Hybrid (Aneksi 8 – Pika 25) –

2. Pyetjet e parashtruara në kërkesën për sqarim (të cituara):

1. Cili është lloji konkret i pajisjes gjeodezike që kërkohet për këtë projekt? A pranohet si I vlefshëm GPS RTK me saktësi nën 2 cm apo kërkohet pajisje Total Station me saktësi më të lartë për vendosje pikat, llogaritje kubaturash, ose kontroll nivelet?

2. Cilat janë pozitat konkrete të paramasës ku kjo pajisje është e domosdoshme për zbatim? A kërkohet përdorimi i saj vetëm në fazën e trasimit fillestar dhe kontrollit gjeometrik apo edhe gjatë gjithë zbatimit të punimeve?

3. A do të pranohen pajisje të kontraktuara për përdorim përmes bashkëpunimit me gjeodetë të licencuar që posedojnë pajisje gjeodezike të certifikuar, në vend të posedimit të drejtpërdrejtë nga ana e OE-së?

3. Përgjigja e AK dhe vlerësimi teknik:

- AK nuk ka dhënë asnjë përgjigje specifike teknike për këtë pikë, as për llojin, as për saktësinë, dhe as për mënyrën e përdorimit të pajisjes gjeodezike;

- Nuk ka specifikuar:

- o Nëse kërkohet GPS RTK, Total Station apo tjetër;

- o Nëse kërkesa është për instrument në pronësi të OE, apo pranohet përdorimi përmes gjeodetëve të licencuar;

- o Nëse pajisja duhet të jetë në dispozicion gjatë gjithë kohës apo vetëm në fazat kyçe të trasimit dhe kontrollit.

4. • Të gjitha projektet ndërtimore përfshijnë përdorimin e pajisjeve gjeodezike, por:

- o Këto zakonisht janë të përdorura nga gjeodetë të licencuar me pajisjet e veta;

- o OE-të në praktikë kontraktajnë gjeodetë të certifikuar nëse nuk i posedojnë vetë pajisjet;

- Në këtë rast, AK:

- o Nuk ka treguar asnjë lidhje konkrete me ndonjë pozicion të paramasës që kërkon përdorim të specializuar të një pajisjeje të caktuar;

- o Nuk ka vendosur specifikim teknik minimal, çka e bën kërkesën të paqartë dhe potencialisht të rrezikshme për interpretim arbitrar nga komisioni vlerësues.

5. Vlerësim ligjor:

Kjo kërkesë është në kundërshtim me:

- Nenin 7 të LPP-së, sepse:

- o Vendos një kriter teknik të papërcaktuar, duke krijuar pasiguri për OE;

- o Lejon interpretim të gjerë dhe jo të njëjtë për të gjithë ofertuesit;

- Nenin 59 dhe 67.6 të LPP-së, sepse:

- o Nuk jep specifikim minimal teknik;

- o Nuk parashikon mundësinë e përmbushjes përmes palëve të treta të licencuara;

- Nenin 19.2 të Rregullores 002/2024, që kërkon që çdo kriter për pajisje:

“Të jetë i lidhur drejt me objektin e kontratës dhe të jetë i arsyetuar përmes dokumentacionit teknik.”

6. Vendime të OSHP-së me precedent të ngjashëm:

- OSHP nr. 2023/0171
- OSHP nr. 2022/0456 të cilat kanë konstatuar se:

“Vendosja e kërkesave të paqarta për pajisje dhe moslejimi i përmbushjes përmes bashkëpunimit me palë të treta të licencuara përbën kufizim të panevojshëm.”

7. Kërkesë për rishqyrtim:

Kërkojmë që Autoriteti Kontraktues:

- Të sqarojë me urgjencë se cili është lloji dhe përdorimi i kërkuar për pajisjen gjeodezike (GPS RTK, Total Station, Auto Level);
- Të lejojë përmbushjen përmes gjeodetëve të licencuar që përdorin pajisjet e tyre;
- Ose, në mungesë të sqarimit të tillë, të largojë këtë kërkesë nga dokumentet e tenderit, për shkak se:

o Nuk është e specifikuar teknikisht;

o Nuk ka lidhje të dokumentuar me pozitat në paramasë;

o Shkel LPP-në dhe Rregulloren 002/2024.

- Kërkesa e Autoritetit Kontraktues në Aneksin 8 – Kërkesa 4 dhe Dëshmia 4, për “certifikata valide të noterizuara”, është në kundërshtim të drejtpërdrejtë me nenet 26.12 dhe 26.16 të Rregullores;

- Rregullorja ndalon qartë kërkesat për noterizim, përveç kur një ligj tjetër specifikisht e kërkon – gjë që nuk aplikohet për certifikatat ISO;

- Në rast dyshimi, AK ka të drejtë dhe mjet ligjor të kërkojë verifikim nga autoriteti lëshues, pa e ngarkuar OE me shpenzime dhe procedura të panevojshme noteriale.

Bazuar në nenin 26.12 dhe 26.16 të Rregullores së Konsoliduar Nr. 001/2022 të ndryshuar me Nr. 002/2024, kërkojmë që Autoriteti Kontraktues të largojë kërkesën për dorëzim të ‘kopjeve të noterizuara të certifikatave ISO’, pasi kjo kërkesë është në kundërshtim me rregulloren në fuqi, është e panevojshme, joproporcionale dhe cenon konkurrencën e drejtë dhe të barabartë. Prandaj kërkojmë që në dokumentet e tenderit të lejohet dorëzimi i kopjeve të zakonshme të certifikatave valide, të cilat mund të verifikohen nga AK në rast dyshimi

I nderuar Autoritet Kontraktues,

Nëpërmjet kësaj Kërkese për Rishqytrim, kërkojmë anulimin dhe ritenderimin e aktivitetit të lartpërmendur të prokurimit publik. Kjo kërkesë po bëhet pas vërejtjes së shkeljeve serioze ligjore dhe rregullative në dokumentacionin dhe zhvillimin e këtij tenderi, siç argumentohet në vijim:

1. Shkelje të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) Nr. 04/L-042:

Neni 7 – Barazia në trajtim/Jo-diskriminimi: Autoriteti Kontraktues ka detyrimin t'i trajtojë të gjithë operatorët ekonomikë në mënyrë të barabartë, pa vendosur kushte që favorizojnë apo diskriminojnë cilindo prej tyre. Në këtë aktivitet prokurimi, janë vendosur kritere dhe specifikime teknike që në thelb favorizojnë disa operatorë të caktuar, duke kufizuar konkurrencën e drejtë. Kjo përbën shkelje të drejtpërdrejtë të nenit 7 të LPP-së, i cili ndalon përcaktimin e kritereve ose specifikimeve me qëllim favorizimi apo diskriminimi ndaj ndonjë OE

o Neni 49.2 – (Mënyra e komunikimit dhe trajtimi i barabartë i informatave):

Është konstatuar se Autoriteti Kontraktues nuk ka siguruar shpërndarjen e njëjtë dhe transparente të informatave për të gjithë operatorët gjatë procedurës. Ligji kërkon që çdo informacion, njoftim apo dokument i lidhur me tenderin t'u vihet në dispozicion të gjitha palëve njësoj. Mosofrimi i sqarimeve të plota (Pergjigja 01.07.2025 -Ne kerkesen per sqarima 26.06.2025)po informacioneve të barabarta për të gjithë, si dhe mospublikimi i tyre në kohë, bie ndesh me këtë dispozitë. Kjo ka cenuar parimin e transparencës dhe trajtimi i të barabartë, pasi disa operatorë ekonomik mund të kenë mbetur pa informacionin e nevojshëm për përgatitjen e ofertave konkurruese.

o Neni 67.6 – (Dokumentet provuese dhe kërkesat e panevojshme): Ligji për Prokurimin Publik përcakton se Autoriteti Kontraktues duhet të kufizojë kërkesat për dokumente provuese vetëm në ato që janë të domosdoshme dhe relevante për vërtetimin e kualifikimit të operatorëve. Çdo kriter apo dokument i kërkuar që nuk lidhet drejtpërdrejt me lëndën e kontratës apo që nuk është proporcional me të, bie ndesh me ligjin. Në këtë tender, janë kërkuar certifikime apo dokumente (p.sh. certifikime ISO specifike) që nuk kanë justifikim të drejtpërdrejtë teknik me projektin përkatës, dhe që duket se imponohen pa nevojë, duke ngarkuar pa arsyeje operatorët ekonomikë. Këto kërkesa tepruese bien ndesh me parimin e proporcionalitetit dhe me frymën e nenit 67 të LPP-së, që nënkupton se dokumentacioni kualifikues duhet të jetë i arsyeshëm dhe i kufizuar vetëm në atë që realisht nevojitet.

Specifikime teknike joproporcionale dhe kufizuese (Aneksi 8 i Dosjes së Tenderit):

Dokumentacioni teknik (Aneksi 8) parashtroi kërkesa për pajisje dhe makineri jashtëzakonisht të mëdha ose specifike, pa ndonjë justifikim teknik të qartë lidhur me nevojat e projektit. Disa shembuj konkretë: kërkohet disponimi i ekskavatorit 65 ton, makinerie për gërryerje asfalti (frezuese) 42 ton, ngarkues frontal 60 ton, kamion

dumper me sistem matës digjital, dron për survejim, si dhe posedimi i certifikatave ISO që nuk dihen të jenë të domosdoshme për realizimin e këtij projekti. Këto kërkesa tejkalojnë dukshëm atë që do të ishte e mjaftueshme e proporcionale për qëllimet e kontratës, duke vendosur barriera artificiale për shumë operatorë ekonomikë. Praktikisht, vetëm një numër shumë i kufizuar operatorësh (ose ndoshta vetëm një i paracaktuar) mund të plotësojnë kushte kaq specifike dhe

strikte, gjë që cënon rëndë konkurrencën e lirë dhe sugjeron favorizim. Kriteret dhe kërkesat e tilla joproporcionale bien ndesh si me parimet themelore të LPP-së (neni 7) ashtu edhe me dispozitat që kërkojnë relevancë dhe proporcionalitet të kriterëve. Autoriteti Kontraktues duhet të kërkojë vetëm pajisje aq sa kërkon natyra e punimeve; kërkitimi i makinerive me kapacitete kaq të rralla pa arsyetim sugjeron se dokumentacioni është hartuar në dëm të konkurrencës së hapur.

2. Mungesa e sqarimeve dhe përgjigjeve adekuate nga Autoriteti Kontraktues:

Gjatë periudhës së dhënies së sqarimeve, janë parashtruar pyetje nga operatorët ekonomikë për të adresuar pikëpyetjet dhe problemet e mësipërme. Autoriteti Kontraktues nuk ka ofruar përgjigje fare për disa prej këtyre pyetjeve, ndërsa për disa të tjera janë dhënë përgjigje tepër të përgjithshme, që nuk e zgjidhin shqetësimin e ngritur. Ky veprim (ose mosveprim) është në kundërshtim me parimet e transparencës dhe llogaridhënies në prokurim. Rregullat në fuqi kërkojnë që Autoriteti Kontraktues të shqyrtojë menjëherë çdo kërkesë për sqarim dhe, nëse pyetjet konsiderohen të rëndësishme, t'u ofrojë të gjithë operatorëve ekonomikë informacionin shtesë të nevojshëm menjëherë përmes platformës elektronikee-prokurimi.rks-gov.net. Për më tepër, nëse këto sqarime jepen afër skadimit të afatit të ofertimit, AK-ja obligohet të zgjasë afatin kohor për dorëzimin e ofertave, në mënyrë që të mos dëmtohet asnjë operator nga koha e pamjaftueshme. Në këtë rast, mungesa e përgjigjeve konkrete dhe mosshpallja e ndonjë shtyrjeje të afatit ka lënë operatorët në pasiguri dhe në pozita të pabarabarta. Dështimi i AK-së për t'iu përgjigjur plotësisht dhe në kohë pyetjeve për sqarim përbën shkelje procedurale, e cila minon parimin e barazisë në trajtim dhe cënon besimin në procesin tenderues.

3. Mospërputhje me parimet themelore të proporcionalitetit, konkurrencës dhe barazisë:

Si përmbledhje e pikave të mësipërme, rezulton qartë se dokumentacioni dhe veprimet e Autoritetit Kontraktues nuk janë në përputhje me parimet bazë të prokurimit public – proporcionalitetin, konkurrencën e lirë dhe trajtimin e barabartë. Kërkesat e tepërta dhe të pajustificuara teknikisht shkelin parimin e proporcionalitetit, sepse vendosin kritere që nuk qëndrojnë në raport të arsyeshëm me objektin dhe vlerën e kontratës. Këto kërkesa, së bashku me mospërgjigjen ndaj sqarimeve, kufizojnë konkurrencën, duke dek urajuar ose përjashtuar ofertues potencialisht të kualifikuar pa arsye ligjore. Po ashtu, favorizimi implicit i një OE (ose një grupi të vogël OE-sh që mund të plotësojnë kriteret e pazakonta) bie ndesh me parimin e barazisë në trajtim dhe jep shenja të diskriminimit. Legjislacioni i prokurimit publik në Kosovë e thekson se autoritetet kontraktuese nuk duhet të ekzekutojnë asnjë aspekt të prokurimit në mënyrë që redukton konkurrencën ose diskriminon operatorët. Në këtë tender, veprimet dhe kërkesat e AK-së fatkeqësisht prodhojnë pikërisht atë efekt: zvogëlim të konkurrencës dhe trajtim jo të barabartë.

Përfundimisht, duke u mbështetur në nenin 62.1 të Ligjit për Prokurimin Publik, i cili përcakton se Autoriteti Kontraktues mund të përfundojë (anulojë) një aktivitet prokurimi kur një shkelje e ligjit ka ndodhur ose pritet të ndodhë dhe nuk mund të parandalohet ose korrigjohet me mjete të tjera përveç anulimi kërkojmë nga Autoriteti Kontraktues anulimin e menjëhershëm të këtij aktiviteti të prokurimit. Shkeljet e lartpërmendura janë themelore dhe të pariparueshme brenda kësaj procedure (ato nuk mund të zgjidhen me një “ndryshim të vogël” apo sqarim shtesë, pa rrezikuar ligjshmërinë dhe integritetin e garës). Prandaj, anulimi i tenderit dhe ritenderimi i tij me dokumentacion të rishikuar, ligjërish të përputhshëm, është zgjidhja e vetme që garanton respektimin e ligjit dhe krijimin e kushteve të barabarta e jopërrjashtuese për të gjithë operatorët ekonomikë të interesuar.

Ju lutemi që kjo kërkesë të shqyrtohet me prioritet. Nëse aktiviteti i prokurimit nuk anulohet në përputhje me sa më sipër, ne si palë e interesuar do të detyrohemi të ndjekim rrugët e tjera ligjore për mbrojtjen e së drejtës sonë dhe sigurimin e një procesi të drejtë prokurimi.

Pretendimet ankimore të parashtruara në ankesën e deponuar në OSHP, janë të njëjta.

Përgjigje e Autortitetit Kontraktues ndaj kërkesës për rishqyrtim:

Përgjigje e pretendimit ankimor 1:

Kërkesa e autoritetit kontraktues është e bazuar në Ligjin për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.

Neni 68 Gjendja Ekonomike dhe Financiare Paragrafi 1. Autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga operatorët ekonomikë që të parashtrorjnë të dhëna për të treguar se ata i përmbushin kushtet minimale ekonomike dhe financiare të specifikuara në dosjen e tenderit dhe në njoftimin e kontratës. Kur kërkohet, qarkullimi minimal vjetor që operatorët ekonomikë duhet të kenë nuk do të kalojë dy herë vlerën e parashikuar të kontratës. Kërkesat mbi gjendjen ekonomike duhet të shprehen detyrimisht në shifra dhe do t'i referohen maksimum tri viteve të fundit financiare. Kur përveç qarkullimit minimal, është i nevojshëm një qarkullim i caktuar minimal në fushën specifike të mbuluar nga kontrata, qarkullimi i tillë nuk duhet të tejkalojë një pikëpesë (1.5) herë vlerën e parashikuar të kontratës. D.m.th. kërkesa e AK-së nuk tejkalon dy herë vlerën e parashikuar të kontratës së projektit nga AK.

Përgjigje e pretendimit ankimor 2:

Kërkesa e autoritetit kontraktues është e bazuar në Ligjin për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.

Neni 69 Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale Paragrafi 6. Në procedurat që shpijnë në dhënien e kontratës publike në të cilën përfshihet realizimi i projekteve të punëve ose realizimi i aktiviteteve ndërtimore, autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga operatorët ekonomikë të sigurojnë të dhënat me të cilat dëshkohet aftësia e tyre teknike dhe profesionale për kryerjen e projekteve të tilla ose realizimin e aktiviteteve të tilla; në veçanti, autoriteti kontraktues mund të kërkojë të dhëna përkitazi me nënparagrafin 6.1. kualifikimet shkollore dhe profesionale të personelit udhëheqës të operatorit ekonomik dhe, në veçanti, të personit ose personave që drejtpërdrejt është ose janë përgjegjës për realizimin e projekteve të punës ose për realizimin e aktiviteteve ndërtimore.

Përgjigje e pretendimit ankimor 3:

Të gjitha pajisjet e kërkuara janë kërkuar sipas natyrës, vëllimit dhe dinamikës së punës së nevojshme (ndërtimi i rrugës dhe devijimi), prandaj edhe kjo kërkesë mendojmë se është e arsyeshme dhe e nevojshme sasia sipas listës së pajisjeve të kërkuara në dosje të tenderit.

AK pas rishqyrtimit të pretendimeve ankimore ka konstatuar se NUK QËNDROJNË pretendimet ankimore të Operatorit Ekonomik SEFERI-CO SH.P.K. dhe kërkesa për rishqyrtim refuzohet.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 10.07.2025 ka autorizuar ekspertin/technik për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe

pretendimeve sipas ankesës me nr. 0624/2025, ndërsa me datë 22.07.2025 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues/teknik me nr. 2025/0624 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues/teknik i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar, AK të bëjë përmirësimet në dosje të tenderit dhe të zgjasë afatin për ofertim.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale, Autoriteti kontraktues nuk pajtohet rreth raportit të ekspertit shqyrtues ndërsa OE pajtohet rreth raportit të ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marrë parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritues lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE SEFERI-CO SH.P.K., eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2025/0624 ka vlerësuar si në vijim:

Përgjigje në Pretendimi nr.1

Pretendimi ankimor i OE ankues në këtë pikë ka të bëjë me kërkesat e FDT-se 8.1 & 8.2 mbi kapitalin e mjaftueshëm të kerkuar financiar prej 500,000.00 € e që është kerkuar që lideri i grupit të mbulojë 60 % të mbështetjes bankare.

OE pretendon se kërkesa nuk është e arsyetuar financiarisht dhe ekonomikisht dhe është në kundërshtim me nenin 7 dhe 67.6 të LPP-se, nenin 27 të RRPP 002/2024, joproporcionale me natyrën dhe madhësinë e kontratës, si dhe në kundërshtim me nenin 3.3.1 dhe 3.3.2 të UOPP 001/2023.

Lidhur me pretendimin ankimor të OE ankues, eksperti shqyrtues sqaron se bazuar në UOPP nenin 8.5 paragrafi (ii) a. është e lejuar që të kerkohen raportet nga një ose më shumë banka në mënyrë që të vërtetohet se tenderuesi ka stabilitetin e mjaftueshëm financiar dhe ekonomik për të përformuar kontratën e propozuar. Për më tepër kërkesa e AK-se në këtë pikë është në përputhje me shembullin e dhënë në UOPP për asetet likuide apo mbështetjen nga banka dhe se është në përgjegjësinë e AK-se të vendos vlerën e kerkuar për aktivitetin në fjalë.

Prandaj bazuar në sqarimet e mësipërme eksperti shqyrtues vlerëson se kërkesa e AK-se për kapitalin financiar është në përputhje me UOPP 001/2023 dhe se pretendimi ankimor i OE ankues në këtë pikë nuk është i bazuar.

Përgjigje në Pretendimi nr.2

Pretendimi i OE ankues në këtë pikë ka të bëjë me kërkesën 2 të FDT-se Kërkesa 2 - Numri i punëtorëve të angazhuar në këtë projekt, min. 30 punëtor me të dhënat në vijim Emri, mbiemrin,

mosha e punëtorit, profesioni, eksperiencia (vite) dhe pozicioni në kompani. (nga 30 puntore prej tyre 8 te jene me certifikata per siguri dhe shendet ne pune si dhe certifikata per mbrojtje kunder zjarrit, ndersa 2 punetor te jene te trajnuar per ndihme te pare)

OE ankues pretendon se kerkesa nuk është ne perputhje me nenin 7 dhe 67.6 te LPP-se.

Lidhur me këtë pretendim me daten 04.06.2025 është dhene edhe nje rekomandim nga KRPP qe te rishiqohen keto kerkesa me theks te veqante ne certifikimet per siguri dhe shendet ne pune.

Eksperti shqyrtues vlereson se kerkesa per certifikime te punetoreve bie ndesh me nenin 7 te LPP-se si dhe nenin 4.3 paragrafi a), b), c), e) te RRPP 002/2024, poashtu është ne kundërshtim edhe me nenin 9 dhe 10 te Ligjit 04/L-161 per Siguri dhe Shendet ne pune “Neni 9 Shërbimet për mbrojtjen dhe parandalimin

1. Çdo punëdhënës është i detyruar të ngarkojë një ose më shumë të punësuar, për të kryer aktivitete nga siguria dhe shëndeti në punë, nëse nuk është përcaktuar ndryshe me këtë ligj.

Neni 10 - 1. Punëdhënësi i cili punëson deri në pesëdhjetë (50) të punësuar, nëse është i aftë/kompetent, mund të marrë vetë përgjegjësinë për zbatimin e masave të përcaktuara në paragrafin 1. të nenit 9 të këtij ligji, me kusht që t'i plotësojë kushtet dhe kriteret sipas paragrafit 5. të nenit 9 të këtij ligji.

Si perfundim, eksperti shqyrtues vlereson se AK gjate pergatitjes se dosjes se tenderit nuk ka vepruar ne perputhje me nenin 7 te LPP-se, nenin 4.3 dhe 17.17 te RRPP 002/2024 si dhe rekomandimin e KRPP-se dhe se pretendimi ankimor është i bazuar.

Përgjigje në Pretendimi nr.3

Pretendimi i OE ankues ne këtë pike ka te bëjë me kerkesen 3.1. Menaxheri i projektit – Inxhinier i Diplomuar Ndërtimtarisë ose master – Drejtimi Konstruktiv, me përvojë pune min. 10 vite pas diplomimit, i njejti duhet te jetë i çertifikuar me ISO “Welding supervisor according to ISO 14731

Diplomat përkatëse – Kopje, Nëse shkollimi është kryer jashtë Kosovës diploma e fakultetit duhet të jetë e nostrifikuar konform ligjeve në fuqi të Republikës së Kosovës;

OE pretendon se kerkesa per certifikim me standard ISO 14731 dhe pervoja e kerkuar prej 10 vite nuk është ne perputhje me nenin 7 te LPP-se.

Lidhur me këtë pretendim me daten 04.06.2025 është dhene edhe nje rekomandim nga KRPP:

KRPP Rekomandon Autoritetin Kontraktues të veprojë në pajtim me Nenin 69.6.1 i LPP-së, i cili specifikon se:“ kualifikimet shkollore dhe profesionale të personelit udhëheqës të operatorit ekonomik dhe, në veçanti, të personit ose personave që drejtpërdrejt është ose janë përgjegjës për realizimin e projekteve të punës ose për realizimin e aktiviteteve ndërtimore”.

Gjithashtu, Tek Dëshmia: keni kërkuar - diploma të nostrifikuara. KRPP Rekomandon-Autoritetin Kontraktues të rishqyrtoni edhe njëherë këto kërkesa me qëllim që Stafi i cili kryen shërbime për kohë të caktuar a është obligative të jenë diplomat e nostrifikuara.

Eksperti shqyrtues vlereson se kerkesa per ISO 14371 dhe kerkesa per ISO 3834 jane dy standarde qe mbulojne fushen e saldimit dhe sikurse është rekomanduar edhe ne pretendimin 11 AK duhet

te shikoje mundesine qe kerkesa te mbetet tek kerkesa 3.1 apo te ISO standardet e mbuluara me kerkesen 4, rrjedhimisht pretendimi ankimor ne këtë pike është pjeserisht i bazuar.

Përgjigje në Pretendimi nr.4

Pretendimi i OE ankues ne këtë pike ka te bëjë me kerkesen 3.2. Udhëheqësi i Punishtes – Inxhinier i Diplomuar Ndërtimtarisë ose master – Drejtimi Konstruktiv, me përvojë pune min. 5 vite pas diplomimit, i njejti duhet te jetë i çertifikuar si përgjegjës për Sigurimin dhe kontrollin e mjedisit, dhe nga lëmia e sigurisë, shëndetit në punë dhe mbrojtjes kundër zjarrit;

OE ankues pretendon se kerkesa është ne kundershtim me nenin 7 dhe 67 te LPP-se dhe krijojne diskriminim ndaj OE te interesuar per këtë aktivitet te prokurimit.

Ne kerkesen per sqarim te OE ankues AK ka dhene aryetimin mbi certifikimet e kerkuara per udheheqesin e punishtes.

Eksperti shqyrtues sqaron se e njejta kerkese është kerkuar edhe ne kerkesen 2 per te gjithë stafin e cila është vleresuar se është ne kundershtim me nenin 7 te LPP-se si dhe nenin 9 dhe 10 te Ligjit 04/L-161 prandaj AK duhet te kujdeset qe kerkesat per certifikime te shperndahen ne menyre proporcionale prandaj vlereson se kerkesa e centralizuar per tri certifikime te kerkuara ne nje pozite nuk është ne perputhje me nenin 7 te LPP-se, Nenin 17.17 dhe 25.17 te RRPP 002/2024 dhe se pretendimi është i bazuar.

Përgjigje në Pretendimi nr.5

Pretendimi i OE ankuesne këtë pike ka te bëjë me kerkesen 3.3. Inxhinier i Diplomuar i Ndërtimtarisë ose master - Drejtimi Hidroteknike - me përvojë pune min. 10 vite pas diplomimit;

OE ankues pretendon se kerkesa per Inxhinier te drejtimit Hidro dhe pervoja e kerkuar nuk jane ne perputhje me nenin 7 dhe 67.6 te LPP-se dhe se kerkesa e AK-se ka te bëjë me shume me ndertimtari rrugore.

Per me teper OE ankues pretendon se esht en kundershtim me praktikat e vendosura nga OSHP permes vendimeve:

- OSHP nr. 2022/0611 dhe
- OSHP nr. 2023/0171

Jane vendime te cilat i referohen pretendimeve te njejta.

Lidhur me këtë pretendim AK ka dhene nje sqarim nje shkresen e dates 01.07.2025.

Sipas LPP_se neni 9 Përcaktimi i nevojaveqë duhet përmbushur e përcakton se Autoritet i vetëm ne përcaktimin e vleresimit te nevojave qe duhet përmbushur është AK-ja prandaj eksperti shqyrtues vlerëson se përgjegjësia ekskluzive ne përcaktimin e nevojave dhe qe aktiviteti i prokurimit te rezultojë me kontrate është ekskluzivisht i AK-së. Poashtu është përgjegjesi e AK-se qe perpilimi i odsjes se tenderit te behet ne pëputhje me nenin 11.3, 17.15 dhe 17.17 te RRPP 002/2024.

Eksperti shqyrtues sqaron se kerkesa prej 10 viteve pervoja profesionale nuk është e ndaluar specifikisht me dispozitat e LPP-se dhe RRPP-se. Argumentimi i OE ankues ne këtë pike duke u

thirrur ne nenin 67.6 te LPP-se nuk është i sakte sepse ne LPP nuk ekziston neni te cilit OE ankues i referohet. Sa i perket nenit 7, eksperti shqyrtues vlereson se OE ankues nuk e ka argumentuar se si është diskriminuar apo favorizuar ndonje OE i caktuar.

Per me teper argumentimi permes vendimeve te kaluara te OSHP-se është i gabuar duke pas parasysh se te dy vendimet qe referohen ne këtë pretendim nuk kane te bejne fare me pretendimin e OE ankues.

- OSHP nr. 2022/0611 – Ska te bëjë me ndertim (trajtimi i qeneve endacak - veterinari)
- OSHP nr. 2023/0171 – Ska te bëjë me ate qe pretendohet ne këtë pike ankimore

Si perfundim eksperti shqyrtues vlereson se OE ankues nuk e ka argumentuar pretendimin ne menyre te qarte duke marre argumente te cilat nuk kane ndonje lidhje me pretendimin ankimor keshtuqe sipas vleresimit te ekspertit shqyrtues pretendimi ankimor ne këtë pike nuk është i bazuar.

Përgjigje në Pretendimi nr.6

Pretendimi i OE ankues ne këtë pike ka te bëjë me kerkesen 3.4. Inxhinier i Diplomuar Ndërtimtarisë ose master – Drejtimi Konstruktiv, me përvojë pune min. 5 vite pas diplomimit;

OE ankues pretendon se kerkesa nuk ka funksion te qarte teknik ne rpaort me pozitat tjera ekzistuese dhe e vendosur pa analize dhe kerkesa bie ne kundershtrim me nenin 7 dhe 67.6 te LPP-se si dhe RRPP 002/2024.

OE ankues pretendon se është ne kundershtrim me praktikat e vendosura nga OSHP permes vendimeve:

- OSHP nr. 2023/0208 • OSHP nr. 2022/0504

Lidhur me këtë pretendim AK ka dhene nje sqarim nje shkresen e dates 01.07.2025.

Bazuar në nenin 9 të LPP-se, përgjegjësia ekskluzive për përcaktimin dhe vlerësimin e nevojave që duhet përmbushur me këtë kontratë i takon vetëm AK-se. Po ashtu, përgatitja e dosjes së tenderit është përgjegjësi e drejtpërdrejtë e AK-së dhe duhet të jetë në përputhje me nenin 11.3, nenin 17.15 dhe nenin 17.17 të RrPP Nr. 002/2024. Për rrjedhojë, përdorimi i kritereve teknike, përfshirë ato potencialisht diskriminuese apo joproporcionale, si dhe ndikimi i tyre në rezultatin e aktivitetit të prokurimit, mbetet përgjegjësi e plotë dhe ekskluzive e AK-së.”

Eksperti shqyrtues sqaron se kerkesa prej 10 viteve pervojë profesionale nuk është e ndaluar specifikisht me dispozitat e LPP-se dhe RRPP-se. Per me teper sipas kerkeses i bije qe secili qe ka diplomuar para vitit 2015 mund te jete kandidat qe i ploteson kerkesat. Argumentimi i OE ankues ne këtë pike duke u thirrur ne nenin 67.6 te LPP-se nuk është i sakte sepse ne LPP nuk ekziston neni te cilit OE ankues i referohet. Sa i perket nenit 7, eksperti shqyrtues vlereson se OE ankues nuk e ka argumentuar se si është diskriminuar apo favorizuar ndonje OE i caktuar.

Per me teper argumentimi permes vendimeve te kaluara te OSHP-se është i gabuar duke pas parasysh se te dy vendimet qe referohen ne këtë pretendim nuk kane te bejne fare me pretendimin e OE ankues.

- OSHP nr. 2023/0208 – ska te bëjë me pretendimin (pretendimet jane per reference)

- OSHP nr. 2022/0504 – sësthtë shqyrtuar ankesa (hidhet e palejuar)

Si perfundim eksperti shqyrtues vlereson se OE ankues nuk e ka argumentuar pretendimin ne menyre te qarte duke marre argumente dhe duke u mbështëtur ne praktika te vendimeve te cilat nuk nderlidhen me pretendimin ankimor keshtuqe sipas vleresimit te ekspertit shqyrtues pretendimi ankimor ne këtë pike nuk është i bazuar.

Përgjigje në Pretendimi nr. 7

Pretendimi i OE ankues ne këtë pikë ka të bëjë me kerkesen 3.8. Bachelor i Diplomuar i Ndërtimtarisë Arkitekturës, i njejti duhet te jetë i certifikuar me certifikatën (Project Management Professional PMP) me përvojë pune min. 8 vite;

OE ankues pretendon se kerkesa perben:

Mospërputhje të brendshme në vetë logjikën e dokumentit të tenderit;

- Kërkesë jo proporcionale me rolin e parashikuar;
- Diskriminim të kandidatëve të rinj profesionalë, të cilët do të mund të mbulonin me

sukses një pozitë të mbështetjes teknike ose arkitekturore pa qenë të certifikuar PMP dhe me përvojë 8+ vjeçare.

Bazuar në nenin 9 të LPP-se, përgjegjësia ekskluzive për përcaktimin dhe vlerësimin e nevojave që duhet përmbushur me këtë kontratë i takon vetëm AK-se. Po ashtu, përgatitja e dosjes së tenderit është përgjegjësi e drejtpërdrejtë e AK-së dhe duhet të jetë në përputhje me nenin 11.3, nenin 17.15 dhe nenin 17.17 të RrPP Nr. 002/2024. Për rrjedhojë, përdorimi i kriterëve teknike, përfshirë ato potencialisht diskriminuese apo joproporcionale, si dhe ndikimi i tyre në rezultatin e aktivitetit të prokurimit, mbetet përgjegjësi e plotë dhe ekskluzive e AK-së.”

Sa i perket pretendimit te OE ankues mbi këtë pike eksperti shqyrtues vlereson se kerkesa (Bachelor i Diplomuar i Ndërtimtarisë Arkitekturës) eshte i manget duke pas parasysh se nuk specifikohet se a kerkohet drejtimi arkitekture apo lejohen ndertimtati dhe arkitekture prandaj duhet te qartesohen si dhe certifikimi PMP është fushe te cilen mund ta mbuloje secili inxhiner dhe se koncentrimi i certifikimit ne nje inxhiner te caktuar nuk është ne perputhje me nenin 7 te LPP-se.

Si rrjedhoje pretendimi ne këtë pikë vlerësohet si pjesërisht i bazuar.

Përgjigje në Pretendimi nr. 8

Pretendimi i OE ankues ne këtë pikë ka të bëjë me kerkesen 3.9. Pilot Operator i licencuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil për operim me dron

- Operatori duhet te deshmoje licensen per dronin e njejte si cili është i paraqiture ne listën e pajisjeve per piken 3.9

OE ankues pretendon se Kjo kërkesë është në kundërshtim të drejtpërdrejtë me:

- Nenin 7 të Ligjit për Prokurimin Publik, i cili përcakton se kriteret duhet të jenë të nevojshme, proporcionale dhe të arsyetuara;
- Nenin 67.2 dhe 67.6 të LPP-së, ku kërkohet që kërkesat për staf teknik të jenë në funksion të objektit të kontratës dhe të kenë alternativa;
- Rregulloren 002/2024, që saktëson se:

“AK nuk duhet të vendosë kritere të caktuara për personel profesional nëse funksioni i tyre nuk është i lidhur drejtpërdrejt me përmbushjen e kontratës.”

Vendime të OSHP-së për raste të ngjashme:

Vendimet si: • OSHP nr. 2022/0611, • OSHP nr. 2023/0122

“Përdorimi i referencave të përgjithshme ligjore dhe teknike pa lidhje me përmbajtjen e kontratës dhe pa përfshirje në paramasë, përbën shkelje të parimeve të LPP-së dhe diskriminim teknik.”

Lidhur me këtë pretendim AK ka dhënë një sqarim një shkresën e datës 01.07.2025.

Bazuar në nenin 9 të LPP-se, përgjegjësia ekskluzive për përcaktimin dhe vlerësimin e nevojave që duhet përmbushur me këtë kontratë i takon vetëm AK-se. Po ashtu, përgatitja e dosjes së tenderit është përgjegjësi e drejtpërdrejtë e AK-së dhe duhet të jetë në përputhje me nenin 11.3, nenin 17.15 dhe nenin 17.17 të RrPP Nr. 002/2024. Për rrjedhojë, përdorimi i kriterëve teknike, përfshirë ato potencialisht diskriminuese apo joproporcionale, si dhe ndikimi i tyre në rezultatin e aktivitetit të prokurimit, mbetet përgjegjësi e plotë dhe ekskluzive e AK-së.”

Eksperti shqyrtues vlerëson se duke pas parasysh pjesën e pretendimeve që kanë të bëjnë me aneksin 8 dhe përgjigjen në pretendime vlerëson se kërkesa është në përputhje me kërkesën në tabelën e aneksit 8 pika 26, si dhe duke marrë parasysh nenin 8 dhe 9 të LPP-se, AK duhet të vlerësojë domosdoshmerinë e kërkesës në përputhje me pajisjet e kërkuara dhe se pretendimi në këtë pikë është pjesërisht i bazuar.

Përgjigje në Pretendim nr. 9

Pretendimi i OE ankues në këtë pikë ka të bëjë me kërkesën

Kërkesa 4 - Operatori Ekonomik duhet të jetë i pajisur me këto Certifikata ISO

- ISO SA 8000 2014 (Çertifikata) Social Accountability International (SAI)

OE ankues pretendon se certifikata e kërkuar nuk është në pajtim me nenin 7, 59.3 dhe 67.6 të LPP-se si dhe RrPP 002/2024 për shkak se ka të bëjë me respektimin e të drejtave të punëtorëve që janë të rrregulluara me Ligj të Punes në Kosovë.

OE ankues pretendon se kërkesa është në kundërshtim me praktikën e vendosura nga OSHP përmes vendimeve: • OSHP nr. 2022/0587, • OSHP nr. 2023/0141

Në sqarimin e dhënë nga AK kërkesa për këtë kriter është arsyetuar se standardi i kërkuar është kërkuar me qëllim që të promovojë dhe garantojë respektimin e të drejtave të punëtorëve nga ana e Operatorëve Ekonomik.

Eksperti shqyrtues sqaron se standardi i kërkuar, SA 8000, është një standard ndërkombëtar i përgjegjësisë sociale që rregullon kushtet e punës dhe të drejtat e punëtorëve, në përputhje me praktikat më të mira ndërkombëtare. Megjithatë, duke pasur parasysh se në Republikën e Kosovës ekziston një kornizë ligjore e miratuar që rregullon të drejtat dhe detyrimet e ndërsjella ndërmjet punëtorëve dhe OE-ve, përfshirë Ligjin e Punës, Ligji për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë si dhe ligje të tjera përkatëse, eksperti vlerëson se kërkesa për posedimin e këtij standardi si kriter i domosdoshëm duhet të arsyetohet në mënyrë proporcionale dhe në përputhje me natyrën e kontratës publike.

Eksperti shqyrtues poashtu sqaron se argumentimi përmes vendimeve të kaluara të OSHP-se është i gabuar duke pas parasysh se të dy vendimet që referohen në këtë pretendim nuk janë shqyrtuar fare dhe janë hedhur poshtë si të jashtëafatshme dhe të palejuar.

OSHP nr. 2022/0587, ska qene ne shqyrtim fare (jashtëafatshme)

OSHP nr. 2023/0141 Ska qene shqyrtim fare (palejuar)

Poashtu edhe argumentimi duke u thirrur në nenin 67.6 të LPP-se nuk është i sakte sepse në LPP nuk ekziston neni të cilit OE ankues i referohet.

Si rrjedhojë eksperti shqyrtues vlerëson se AK duhet të rishikojë domosdoshmerinë e nevojës për posedimin e këtij standardi në kuptimin e nenit 7 të LPP-se dhe se sipas vlerësimit të ekspertit pretendimi ankimor i OE ankues në këtë pike është pjesërisht i bazuar.

Përgjigje në Pretendimi nr. 10

Pretendimi i OE ankues në këtë pikë ka të bëjë me kërkesën Kërkesa 4 – Operatori Ekonomik duhet të jetë i pajisur me këto Certifikata ISO - ISO 28001 2007 (Çertifikata)

OE ankues pretendon se certifikata e kërkuar nuk është në pajtim me nenin 7, dhe 67.6 të LPP-se si dhe RRPP 002/2024.

Poashtu, OE ankues pretendon se kërkesa është në kundërshtim me praktikën e vendosura nga OSHP përmes vendimeve: • OSHP nr. 2022/0512, • OSHP nr. 2023/0190,

Në sqarimin e dhënë nga AK kërkesa për këtë kriter është arsyetuar se standardi është i rëndësishëm për identifikimin dhe menaxhimin e rreziqeve në furnizim që lidhen me sigurinë fizike dhe procedurale dhe parandalimin e ndërhyrjeve të paautorizuara.

Eksperti shqyrtues sqaron se standardi i kërkuar ISO 28001 lidhet me menaxhimin e sigurisë në zingjirin e furnizimit. Duke pas parasysh se rezultati i aktivitetit të prokurimit është kontraktimi i punëve, atëherë AK mund t'i përcaktojë kërkesat e tilla brenda kushteve të kontratës. Në këtë mënyrë, kërkesa që OE-të të posedojnë këtë standard në fazën e ofertimit nuk është në përputhje me nenin 7 të LPP-së, pasi nuk është e lidhur drejtëpërdrejt me realizimin e kontratës në këtë fazë.

Eksperti shqyrtues poashtu sqaron se argumentimi përmes vendimeve të kaluara të OSHP-së është i gabuar, duke pas parasysh se të dy vendimet që referohen në këtë pretendim nuk kanë lidhje me çështjen konkrete dhe nuk krijojnë praktikë të zbatueshme në këtë rast.

OSHP nr. 2022/0512, - ska të bëjë fare me ISO standarde

OSHP nr. 2023/0190, - ska te beje fare me iso standarde

Poashtu, edhe argumentimi duke u thirrur në nenin 67.6 të LPP-së nuk është i saktë, pasi në LPP nuk ekziston dispozita ligjore të cilës i referohet OE ankues.

Si rrjedhojë ekspertit shqyrtues vlereson se AK duhet te rishiqoje dosmosdoshmerine e nevojës për posedimin e këtij standardi në kuptimin e nenit 7 të LPP-se dhe se sipas vleresimit të ekspertit pretendimi ankimor i OE ankues në këtë pikë është pjesërisht i bazuar.

Përgjigje në Pretendimi nr. 11

Pretendimi i OE ankues në këtë pikë ka të bëjë me kërkesën Kërkesa 4 – Operatori Ekonomik duhet të jetë i pajisur me këto Certifikata ISO, ISO 3834-2 2021 (Çertifikata)

OE ankues pretendon se certifikata e kerkuar nuk është në pajtim me nenin 7, 59.3 dhe 67.6 të LPP-se si dhe RRPP 002/2024. Poashtu, OE ankues pretendon se kërkesa është në kundërshtim me praktikën e vendosura nga OSHP përmes vendimeve, • OSHP nr. 2022/0601, • OSHP nr. 2023/0207

Në sqarimin e dhënë nga AK kërkesa për këtë kriter është arsyetuar se standardi i kerkuar është kerkuar si masë parandaluese për të garantuar cilësinë e lartedhë sigurinë teknike të punimeve që përfshijnë elemente metalike që megjithatë nuk janë të detajuara si struktura të medha në paramasë. Këto mund të përfshijnë mbrojtëse rrugore metalike, pjesë ndihmëse për kanalizim dhe sinjalistike rrugore në përputhje me devijimet nga projekti.

Eksperti shqyrtues sqaron se kriteri i kerkuar ISO 3834-2 2021 lidhet me sigurimin e cilësisë në proceset e saldimit me shkrirje. AK në kërkesën 3.1 ka kerkuar që Menaxheri i projektit të jetë i certifikuar me ISO 14731 ndërsa në këtë kërkesë kerkohet që OE të jetë i pajisur me ISO 3834. Duke pasqyruar se të dy standardet kanë të bëjnë me fushën e menaxhimit të cilësisë në saldim dhe duke marrë parasysh arsyetimin e AK-se se ka të bëjë me elemente metalike që megjithatë nuk janë të detajuara si struktura në paramasë ekspertit shqyrtues vlereson se AK duhet të rishiqoje domosdoshmerinë e kërkesës e cila është për dy standarde që kanë të bëjnë me fushë të njëjtë.

Eksperti shqyrtues poashtu sqaron se argumentimi përmes vendimeve të kaluara të OSHP-së është i gabuar, duke pasqyruar se të dy vendimet që referohen në këtë pretendim nuk kanë lidhje me çështjen konkrete dhe nuk krijojnë praktikë të zbatueshme në këtë rast.

- OSHP nr. 2022/0601, - nuk ka të bëjë me atë që pretendohet në këtë ankese

- OSHP nr. 2023/0207 – nuk kanë të bëjnë me kritere por me dëshmi të dorëzuara

Si rrjedhojë ekspertit shqyrtues vlereson se AK duhet të rishiqoje kriterin për standardin në fjalë në kuptimin e nenit 7 të LPP-se dhe se sipas vleresimit të ekspertit pretendimi ankimor i OE ankues në këtë pikë është pjesërisht i bazuar.

Përgjigje në Pretendimi nr. 12

Pretendimi i OE ankues në këtë pikë ka të bëjë me kërkesën Kërkesa 4 – Operatori Ekonomik duhet të jetë i pajisur me këto Certifikata ISO ISO 1452-1 2009 (Çertifikata)

OE ankues pretendon se certifikata e kerkuar nuk është ne pajtim me nenin 7, dhe 67.6 te LPP-se si dhe RRPP 002/2024. Poashtu, OE ankues pretendon se kerkesa është ne kundërshtim me praktikën e vendosura nga OSHP permes vendimeve, • OSHP nr. 2023/0188 • OSHP nr. 2022/0549

Ne sqarimin e dhene nga AK perdorimi i satndardit ISO 1452-2 është arsyetuar se perdoret per gypa PVC U nen presion te cilat perdoren per ujera atmosferike apo te perdorura, te cilat percakton kriteret e sigurisembi kushtet e vendosjes ne toke dhe qe nuk deshtojne ne kushte te ngarkeses statike dhe dinamike.

Eksperti shqyrtues sqaron sestandardi i kerkuar 1452 – 2 Sisteme tubacionesh plastike për furnizimin me ujë dhe për përdorime të tjera nën presion – Tubacione dhe pajisje prej poli(vinil kloridi) pa plastifikues (PVC-U) perdoret edhe ne ndertim rruges, kanalizime atmosferike (ujëra të shiut) nën presion. OE ankues pretendimin e tij e ka mbështetur vetem duke deklaruar se nuk permendet ne paramase, mbingarkuar dhe se nuk është ne perputhje me objektin e kontrates.

Eksperti shqyrtues poashtu sqaron se argumentimi përmes referimit te neneve qe nuk jane pjese e dispozitave te LPP-se dhe vendimeve të kaluara të OSHP-së është i gabuar, duke pas parasysh se të dy vendimet që referohen në këtë pretendim nuk kanë lidhje me çështjen konkrete dhe nuk krijojnë praktikë të zbatueshme në këtë rast.

- OSHP nr. 2023/0188 – (pretendimet jane per oferte e jo per kerkesa te dosjes)

- OSHP nr. 2022/0549 – nuk është shqyrtuar fare (palejuar)

Si perfundim eksperti shqyrtues vlereson se OE ankues ka deshtuar ta argumentojte me fakte dhe argumente te qendrueshme se standardi i kerkuar nuk është ne perputhje medispozitat ligjore te legjislacionit primar apo sekondar dhe si rrjedhoje pretendimi nuk është i bazuar.

Përgjigje në Pretendimi nr. 13

Pretendimi i OE ankues ne këtë pikë ka të bëjë me kerkesen Kërkesa 4 – Operatori Ekonomik duhet të jetë i pajisur me këto Certifikata ISO

BS EN 13331-1 2002 (Çertifikata)

OE ankues pretendon se certifikata e kerkuar nuk është ne pajtim me nenin 7, dhe 59.3 te LPP-se si dhe nenin 19.2 i RRPP 002/2024. Poashtu, ne paramasë nuk ekzistojnë pozita që kërkojnë struktura mbrojtëse për gjurmime. OE ankues pretendon se:

Nuk është e reflektuar në pozicionet e punimeve;

- Nuk është justifikuar teknikisht;
- Është e vendosur në kundërshtim me legjislacionin në fuqi për prokurim publik

Ne sqarimin e dhene nga Ak standardi i kerkuar është asyetuar me paramasen dhe kerkesen per germim te dheut te kategorise III dhe IV deri ne thelesine prej 3m per vendosjen e leshesave dhe themeleve per kanalizim.

Eksperti shqyrtues vlereson se standardi i kerkuar BS EN 13331-1 2002 perdoret per pajisje të përkohshme ndërtimore – Sistemet e mbrojtjes për hendekë. Ne paramasen e bashkangjitur ne dosjen e tenderit ne pozicionin 5 te paramases kerkohet germimi deri ne 3m thellesi. Duke pas parasysh faktin qe ka te beje me mbrojtjen dhe sigurine e punetoreve ne pune dhe se paramasa dhe parallogaria e parasheh germimin te cilin e mbulon edhe standardi i kerkuar eksperti shqyrtues vlereson se pretendimi i OE ne këtë pike është pjeserisht i bazuar.

Përgjigje në Pretendimet te cilat kane te bejne me Makinerine (14 - 28)

Pretendimet e OE ankues kane te bejne te gjitha me makinerine e kerkuar sipas Aneksit 8 Lista e Makinerise e cila sipas FDT-se është kerkuar:

Kokë tërheqëse, pesha min 26 ton – 1 cope

Gjysëmrimorkio me pesh 65-70 ton - 1 cope

Ekskavator për gërmim mbi 50 Ton – 1 cope

Ekskavator për gërmim min 65 Ton- 2 cope

Buldozer – 4 cope

Cilindër vibrues (Makinë ngjeshese) min. 26 Ton – 1 cope

Ngarkues 3-4 m³- 4 cope

Ngarkues me zingjire min 22 ton – 1 cope

Ngarkues min. 60 ton – 1 cope

Dumper deri 5 ton me matje digjitale – 1 cope

Makineri per prerjen-grryerjen e Asfaltit min 42 ton – 1 cope

Kamion kiper për transport të asfaltit të gatshëm min. 20 ton – 5 cope

Ngjeshese Hidraulike qe montohet ne eskavator me peshe 900-1000 kg – 1 cope

Paisje gjeodezike Stacion Total me sistemin Hybrid – 1 cope

Dron i pajisur me sensor LIDAR dhe me mundësi operimi RTK dhe PPK. Droni të jetë i regjistruar në Autoritetin e Aviacionit Civil. – 1 cope

OE pretendon se kërkesa shkel nenin 7 të LPP-së, për shkak se nuk është proporcionale dhe kufizon pjesëmarrjen pa bazë teknike;

- Nuk përmbush nenin 67.6 të LPP-së, pasi nuk janë ofruar alternativa si nënkontraktim apo mjete ekuivalente;

- Nuk respekton nenin 19.2 të Rregullores 002/2024, që kërkon lidhje të drejtëpërdrejtë ndërmjet kërkesës dhe përmbajtjes së kontratës.

Neni 49.2 i LPP-së e obligon AK të japë përgjigje të saktë, të qartë dhe në mënyrë të plotë, për secilën kërkesë të sqarimit të parashtruar nga OE Të rishikojë dokumentet e tenderit dhe të largojë çdo kërkesë që nuk bazohet në dokumentacionin teknik të kontratës, në përputhje me nenin 67 të LPP-së dhe Rregulloren 002/2024.

Neni 59.3 dhe 67.6 i LPP-së kërkon që kërkesat për pajisje të jenë objektivist të nevojshme dhe të justifikohen me analizë funksionale;

Poashtu, OE ankues pretendon se Vendimet e OSHP-se të dhena me poshtë i paraqesin shkeljet e AK-se gjatë percaktimit të kriterëve të cilat sipas vendimeve janë për raste të ngjashme me konstatimet:

- OSHP nr. 2023/0122 – ska të beje me atë që pretendohet ketu (konsulence)
- OSHP nr. 2022/0579 – ska të beje me atë që pretendohet (pretendimet janë pas dorezimit të ofertës)

kanë konstatuar se:

Kërkesat për pajisje specifike të klasës së rëndë, të cilat nuk përputhen me natyrën e punimeve dhe nuk mbështeten në dokumentacionin teknik, janë diskriminuese dhe joproporcionale.”

- OSHP nr. 2023/0131 - ska të beje me atë që pretendohet (pretendimet janë pas dorezimit të ofertës)
- OSHP nr. 2022/0467 - ska të beje me atë që pretendohet (trajtim i qenve endacak)

kanë theksuar se:

Percaktimi i pajisjeve të klasës së rëndë, pa analizë të objekteve konkrete, konsiderohet kriter I panevojshëm dhe përjashtues.”

- OSHP nr. 2023/0143 - ska të beje me atë që pretendohet (pas dorezimit të ofertave – për sigurim fizik)
- OSHP nr. 2022/0485 - ska të beje me atë që pretendohet (pretendim për libere të kamionit)

theksojnë:

Kriteret që vendosen pa bazë në analizën e përmbajtjes teknike të kontratës dhe që tejkalojnë nevojat reale të projektit janë joproporcionale dhe kufizuese.”

- OSHP nr. 2023/0146 - - ska të beje me atë që pretendohet (konsulence inxhinerike)
- OSHP nr. 2022/0480 - ska të beje me atë që pretendohet (regjistrim të popullsisë)

kanë konstatuar se:

Vendosja e kërkesave për pajisje të dimensioneve ekstreme, pa lidhje direkte me objektin dhe pa analizë të përmbajtjes së kontratës, është praktikë e papranueshme dhe diskriminuese.”

- OSHP nr. 2023/0117 - ska te beje me ate qe pretendohet (asgjesim i barnave pretendimet per dok pershtatshmerise)
- OSHP nr. 2022/0451 - - ska te beje me ate qe pretendohet (furnizim – pretendimet pas dorezimit te ofertes)

Në të dy vendimet, paneli ka konstatuar se:

Vendosja e kërkesave për numër të lartë të pajisjeve pa bazë në analizën e volumit dhe dinamikës së punimeve është joproporcionale dhe kufizuese.”

- OSHP nr. 2023/0115 - ska te beje me ate qe pretendohet (furnizim)
- OSHP nr. 2022/0463 - ska te beje me ate qe pretendohet (transporti nxenesve)

Të cilat konstatojnë se:

Vendosja e pajisjeve të specializuara, pa argument teknik të lidhur me kontratën dhe duke anashkaluar mundësinë e përmbushjes me mjete të krahasueshme, përbën kufizim të pajustificuar.

- OSHP nr. 2023/0172 - ska te beje me ate qe pretendohet (blerje e aparateve biokimike)
- OSHP nr. 2022/0501 - ska te beje me ate qe pretendohet (hartim i projekteve)

të cilat kanë konstatuar:

Vendosja e teknologjive specifike (si matje digjitale) në mjete ndihmëse pa lidhje funksionale me përmbajtjen e kontratës është praktikë diskriminuese dhe e papranueshme.”

- OSHP nr. 2022/0532 – ankesa nuk është shqyrtuar fare (palejuar)
- OSHP nr. 2023/0174 - ska te beje me ate qe pretendohet (blerje e pajisjeve dron)

konstatojnë se:

Vendosja e pajisjeve specifike për një pozicion të vetëm të kontratës, pa lidhje me vëllimin aponatyrën reale të punimeve, përbën kufizim të panevojshëm.”

- OSHP nr. 2022/0562 - ska te beje me ate qe pretendohet (pas dorezimit te ofertave)
- OSHP nr. 2023/0169 - ska te beje me ate qe pretendohet (furnizim me targa)

ku është konstatuar se:

Kriteret e vendosura me përshkrime të paqarta teknike ose që nuk saktësojnë parametrat e kuptueshëm të përmbushjes përbëjnë kufizim të panevojshëm dhe janë në kundërshtim me nenin 59 të LPP-së.”

- OSHP nr. 2023/0134, - ska te beje me ate qe pretendohet (furnizim me klor)
- OSHP nr. 2022/0582 - ska te beje me ate qe pretendohet (furnizim me gjenerator)

konstatojnë se:

Vendosja e kriterëve teknike që përjashtojnë pajisje të barasvlershme për nga kapaciteti dhe performanca, pa justifikim teknik të lidhur me kontratën, është joproporcionale dhe e papranueshme.”

- OSHP nr. 2022/0603 - ska te beje me ate qe pretendohet (furnizim me uniforma)
- OSHP nr. 2023/0137 - ska te beje me ate qe pretendohet (trajtim i qenve endacak)

ku paneli ka konstatuar:

“Vendosja e kriterëve për pajisje që nuk janë të reflektuara në dokumentet e kontratës ose paramasë, dhe që nuk janë domosdoshmëri teknike, përbën kufizim dhe është në kundërshtim me LPP.”

- OSHP nr. 2023/0147 - ska te beje me ate qe pretendohet (deratizim - jashtëafatshme)
- OSHP nr. 2022/0428 - ska te beje me ate qe pretendohet (servisim i vetureve)

Kërkesat për pajisje të pa reflektuara në paramasë ose që nuk janë pjesë e metodologjisë së punimeve përbëjnë kufizim teknik të pajustificuar dhe cenojnë barazinë në konkurrencë.”

- OSHP nr. 2023/0171 (pretendime ne anulim)
- OSHP nr. 2022/0456 (cmimet jonormalisht te ulta)

të cilat kanë konstatuar se:

Vendosja e kërkesave të paqarta për pajisje dhe moslejimi i përmbushjes përmes bashkëpunimit me palë të treta të licencuara përbën kufizim të panevojshëm.”

AK ne kerkesen per sqarim te dates 24.06.2025 te OE ankues është përgjigjur përmes sqarimeve ne shkresen e dates 01.07.2025 me te cilen ka arsyetuar ne pretendimet e paraqitura. (bashkangjitur kesaj ekspertize)

- Sqarim per kereksen 3.9 te FDT-se
- Sqarim per koken terheqese (26ton)
- Sqarim per gjysme rimorkion 65-70 ton
- Sqarim i kerkesave ne Aneksin 8 (Lista e Makinerise)

Eksperti shqyrtues sqaron se ne baze te nenit 8 dhe nenin 9 të LPP-se, përgjegjësia ekskluzive për planifikimin, përcaktimin dhe vlerësimin e nevojave që duhet përmbushur i takon vetëm AK-se. Po ashtu, përgatitja e dosjes së tenderit është përgjegjësi e drejtpërdrejtë e AK-së dhe duhet të jetë në përputhje me nenin 11.3, nenin 17.15 dhe nenin 17.17 të Rregullores Nr. 002/2024. Për rrjedhojë, përdorimi apo mospërdorimi i kriterëve teknike, përfshirë ato potencialisht diskriminuese apo joproporcionale, si dhe ndikimi i tyre në rezultatin e aktivitetit të prokurimit, mbetet përgjegjësi e plotë dhe ekskluzive e AK-së.

Sa i përket pretendimeve ankimore të OE ankues në lidhje me paraqitjen e vendimeve të OSHP-së si argument për shkeljet e supozuara të AK-se në këtë aktivitet të prokurimit, eksperti shqyrtues ka analizuar secilin prej këtyre vendimeve dhe ka konstatuar se asnjëri prej tyre nuk është i aplikueshëm për rrethanat konkrete të kësaj ankese. Siç është sqaruar veç e veç për çdo vendim të marre si arsyetim në pretendime, përfundimi i OE ankues se këto vendime përbëjnë precedentë të zbatueshëm për rastin në fjalë është i pasaktë dhe i pambështetur në dispozitat ligjore të Legjislacionit primar apo sekondar.

Poashtu bazuar në shkeljet e pretenduara eksperti shqyrtues sqaron se pretendimi i OE ankues mbi shkeljet të nenit 59.3 dhe 67.6 i LPP-se nuk është i sakte sepse Neni 59.3 aplikohet për ofertat me gabime aritmetike dhe Neni 67 Provat Shkresore përbehet nga dy nene dhe se shkeljet e supozuara nuk janë pjesë e këtij neni.

Sidoqoftë eksperti shqyrtues ka analizuar të gjitha shkresat e lendes, pretendimet ankimore (ato që mund të aplikohen), pergjigjet në kërkesën për sqarim, si dhe vendimin në kërkesë për rishqyrtim dhe vlerëson se përkundrazi sqarimeve dhe deshmive tjera pretendimet për:

Eksperti shqyrtues vlerëson se të pretendimi që ka të bëjë me:

Ekskavator për gërmim mbi 50 Ton;

Ekskavator për gërmim min 65 Ton

Kërkesat janë të perseritura për makineri të njëjta me funksion të njëjta prandaj AK duhet të shqyrtojë mundësinë e heqjen se njëres nga kërkesat dhe të mbetet vetëm një kërkesë e konsoliduar.

Pretendimet për:

Ngarkues 3-4 m³ - 4 cope

Ngarkues me zingjire min 22 ton – 1 cope

Kërkesat janë të perseritura për makineri që kanë funksion të njëjta prandaj AK duhet të zvogelojë kërkesën për 4 cope dhe të largojë nga kërkesa ngarkuesin me zingjire.

Pretendimet për:

Kamion kiper për transport të asfaltit të gatshëm min. 20 ton – 5 cope

Kërkesat për kamion kiper min 20 ton janë kërkesa të njëjta të cilat kanë edhe funksion të njëjta me kërkesën në tabelën 1 të Aneksit 8 (kamion kiper për transport të materialit mbi 12 ton) prandaj kërkesa me tonazh më të lartë për një funksion që mund të kryhet edhe me kërkesën që ka tonazh më të ultë konsiderohet si kërkesë diskriminuese dhe e njëjta duhet të largohet në teresi.

Pretendimet për:

Buldozer – 4 cope

AK duhet te shikojë mundësitë e zbritjes së numrit të makinerisë së kerkuar në këtë pikë duke pasqyruar kohezivitetin e përfundimit të kontratës prej 24 muaj.

Vlen të theksohet se me FDT-së, AK ka lejuar që: Në rast se OE nuk posedon pajisjet mbi pronësinë duhet të ofrojë marrëveshjen për marrjen me qira të pajisjeve. Marrëveshja duhet të jetë në emër të këtij projekti me validitet të kohëzgjatjes të kësaj kontrate e nënshkruar dhe vëltuar nga të dyja palët.

Eksperti shqyrtues sqaron se në vlerësimin e pretendimeve janë marrë parasysh edhe vendimet e OSHP-së: 2025/099 i datës 10.04.2025, vendimi 2024/0837 i datës 14.11.2024 dhe Vendimi 2024/1073 i datës 27.01.2025.

Prandaj duke u bazuar në deshmite të ngarkuara në e-prokurim, sqarimet e dhëna nga AK, përshkrimin e pretendimeve nga ana e OE ankues, eksperti shqyrtues vlerëson se AK duhet të harmonizojë dosjen e tenderit të kërkesat e Aneksit 8 në mënyrë që të reflektojnë kërkesat e nenit 7 të LPP-së, dhe nenit 17.17 të RRPP 002/2024 dhe se pretendimet ankimore janë pjesërisht të bazuara.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit dhe analizimit të të gjithë dokumentacionit në platformën e e-prokurimit, pretendimeve ankimore, përgjigjeve të dhëna nga eksperti i çështjes i angazhuar nga OSHP, konsideron se raportet e ekspertizës i përmbajnë apriori elementet qendësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilave dispozita kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë panelin dhe të gjitha palët me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore. Mirëpo duhet theksuar se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Paneli Shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale të tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit. Prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, ndonjë raport dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjyqimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të LPP.

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e Dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit Projekt me bashkfinancim - Ndërtimi i devijimit të rrugës Magjistrale në fshatrat Duhël-Bllacë dhe rruges për tek varrezat e reja të fshatit Bllacë-Suharekë me numër të prokurimit 624-25-4485-5-1-1, një gjë të tillë e ka konstatuar edhe Departamenti i monitorimit- KRPP- së me datën ; 04.06.2025 09:27 i cili ka rekomanduar për korrigjim të dosjes .

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik aprovohet si pjesërisht e bazuar.

Rrjedhimisht, Paneli Shqyrtues mbështetur në nenin 1 dhe 7 të LPP-së ka vendosur lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull Projekt me bashkfinancim - Ndertimi i devijiit te rruges Magjistrale ne fshatrat Duhël-Bllacë dhe rruges per tek varrezat e reja te fshatit Bllacë-Suharekë me numër të prokurimit 624-25-4485-5-1-1, AK të bëjë përmirësimet në dosje të tenderit dhe të zgjasë afatin për ofertimin sipas dispozitave të LPP-së.

Paneli Shqyrtues i shqipton vërejtje ZPP-se , dhe kërkon në të ardhmen ti përmbahet në tërsi dispozitave të LPP-së.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën I të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën II dhe III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 131 të LPP lidhur me nenin 29 paragrafin 3 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën IV të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 4 dhe paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Batisha Ibrahim

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KOMUNA SUHAREKË**
- **OE - SEFERI-CO SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: